



# **Vlerësimi Institucional në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri**

**Raporti i Universitetit “Epoka”  
Maj 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- |   |                    |          |
|---|--------------------|----------|
| 1 | Znj. Mandy Hobart  | Kryetare |
| 2 | Profesor Mark Hunt | Anëtar   |
| 3 | Dr. Benita Starve  | Anëtare  |

Datë: 29 deri më 30 maj, 2017

## **Përmbajtja**

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi .....	2
Raporti i përmbledhur.....	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij .....	8
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet .....	14
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula .....	19
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	25
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre .....	30
Lista e dokumenteve .....	35

## Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i vlerësimit drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-ja i përmbush standardet. Gjithashtu, ky raport, i ndihmon IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesit që ofruet e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënësve të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve të ndërmarra dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

## Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti “Epoka” është një institucion privat, i themeluar fillimisht në vitin 2008 si “Shkolla e Lartë Epoka”, nën pronësinë e kompanisë arsimore “Turgut Ozal”, dhe ndodhet në të dalë të Tiranës, në afërsi të aeroportit. Në vitin 2012, universitetit iu dha leja të ngjitej në rangun e universitetit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Aktualisht, ai ka dy fakultete: Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, i cili ofron programe studimi në inxhinieri ndërtimi dhe kompjuterike, si dhe Qendrën e Kërkimit dhe Projektimit në Arkitekturë; dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative, që ofron programe studimi në financë-bankë, ekonomiks, administrim biznesi, shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Si Qendra e Kërkimit dhe Projektimit në Arkitekturë, ashtu dhe Qendra për Studime Evropiane funksionojnë nën kujdesin e Rektoratit. Për të siguruar përputhshmërinë me ligjin për arsimin e lartë, dhe për të mbajtur statusin e universitetit, për vitin akademik 2017-2018, do të hapet një fakultet i ri, ai i Shkencave Sociale.

Ndërmjet viteve 2012-2016, universiteti u akreditua për të gjitha programet e masterit, ndërsa gjatë vitit 2015-2016 u akreditua për programet e doktoraturës. Megjithatë, disa prej programeve Bachelor janë ende në pritje të konfirmimit përfundimtar të akreditimit nga Bordi i Akreditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si pjesë e kuadrit të riakreditimit periodik.

Misioni i Epokës është të ofrojë “mësimdhënie dhe kërkim novator dhe ndikues përmes krijimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në shkallë ndërkombëtare”. Universiteti ofron 10 programe Bachelor, 17 programe të nivelit Master, duke përfshirë edhe një program të integruar, dhe gjashtë programe Doktorature. Numri i studentëve të tij arrin në 1,709, shtatëdhjetë për qind e të cilëve studiojnë në programet universitare.

Epoka ka krijuar një larmi partneritetesh në mbarë botën, duke përfshirë edhe me universitetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Rumanisë, Polonisë dhe Bullgarisë. Universiteti është anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Universiteteve (IAU) dhe anëtar i asociuar i Shoqatës Evropiane të Universiteteve (EAU), si dhe një prej nënshkruesve të Magna Charta Universitatum. Universiteti angazhohet në një sërë projektesh ndërkombëtare, duke përfshirë projektet Erasmus dhe Horizon 2020.

## Raporti i përmbledhur

Universiteti "Epoka" është një institucion privat i arsimit të lartë që ndodhet në dalje të Tiranës, dhe ofron programe universitare dhe pasuniversitare (Master dhe Doktoraturë) në gjuhën angleze. Përdorimi i kësaj gjuhe si mjet mësimdhënieje e veçon këtë universitet nga institucionet e tjera, që ofrojnë shërbime të ngjashme. Gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm, universiteti kishte dy fakultete, dhe ishte në prag të çeljes së fakultetit të tretë. Shërbimi ofrohet në një kampus të ndërtuar enkas, në të cilin ndodhen auditorë, laboratorë, studio, një bibliotekë, si dhe hapësira moderne sociale dhe argëtuese. Në të ndodhet edhe një konvikt, kapaciteti strehues i të cilit arrin në mbi 100 studentë, si dhe disa mensa dhe ambiente sportive. Të gjitha godinat janë të mirëmbajtura. Misioni i universiteti është të krijojë, shpërndajë dhe zhvillojë dije, që do t'i përgatisin studentët për arritjen e qëllimeve profesionale dhe ndjekur interesat në të mirën e komunitetit kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjatë vitit 2016-2017, u regjistruan 1,709 studentë në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë.

Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) u përgatit nga grupi i ngritur nga universiteti, që përbëhej drejtues të lartë përfaqësues të stafit akademik, personelit mbështetës dhe një përfaqësues i trupës studentore. Projekt raportet iu shpërndanë një audience më të gjerë për diskutim, përpara se të përmbylleshin dhe miratoheshin nga Senati Akademik.

Vizita u krye përgjatë dy ditëve, në datat 29 dhe 30 maj të vitit 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë, nga personeli i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështetet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe dosja me dokumentet mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. U shqyrtuan 56 dokumente gjithsej, të cilat e ndihmuan grupin të njihet me strukturën, politikën dhe procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore, të ndërmarrë nga universiteti. Këto dokumente përfshinin Statutin e Universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, politikën e pranimi, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumet, listën e projekteve kërkimore, shembujt e informimit rreth programeve, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, u organizuan një sërë mbledhjesh, të cilat i dhanë mundësinë Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të kuptonte më mirë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e personelit dhe studentëve. Grupi u takua me Rektorin, drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, personelin mbështetës dhe administrativ, si dhe me partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit. Gjatë mbledhjeve u mbajtën shënime, të cilat shërbenin si burim reference dhe dokumentesh vetëm për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm. Ky i fundit vizitoi edhe kampusin, duke përfshirë bibliotekën, ambientet e mësimdhënies, laboratorët, dhe zyrat, si dhe pati mundësinë të vërente një demonstrim të sistemeve informacionit të universitetit elektronike dhe online. Pasi shqyrtoi të gjitha dokumentet e disponueshme, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e mëposhtme.

Përgjegjësitë për organizimin dhe drejtimin e universitetit përcaktohen qartësisht në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideron strukturat e universitetit për mbështetjen e ofrimit të bursave përmes lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partneritetit me punëdhënësit, si dhe Bordin e Planit Strategjik të Zhvillimit, që mbikëqyr, miraton, zbaton dhe monitoron me efikasitet këtë të fundit, si karakteristika të praktikës së mirë. Ai nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk dha asnjë rekomandim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në anëtarësinë e Këshillit të Etikës, në përputhje me kërkesat e Statutit të rishikuar, dhe

emërimin e Drejtorëve të Qendrave Kërkimore nga muaji shtator i këtij viti, për sigurimin e koordinimit dhe menaxhimit efikas të kërkimit institucional në të gjithë universitetin.

**Standardet I.1- I.6, Standardi II.1, Standardi II.3, dhe Standardet III.1- 4 në Kapitullin III** për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Universiteti “Epoka” ka sisteme të përshtatshme për menaxhimin e përgjegjësive të tij për burimet, infrastrukturën dhe nevojat e personelit dhe studentëve. Rekrutimi i personelit kryhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, ndërsa integrimi i anëtarëve të rinj të personelit mbështetet nga programi në vazhdim i veprimtarive sociale dhe forumeve të hapura, që mundësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e ideve ndërmjet personelit. Kjo gjë, identifikohet si karakteristikë e praktikës së mirë. Universiteti ka vënë në punë sisteme të mirëpërcaktuara për menaxhimin e të dhënave dhe informacionin studentor. Megjithatë, roli i fakulteteve në rishikimin, hartimin dhe menaxhimin e buxhetit është i paqartë, dhe si rrjedhojë, identifikohet si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon universitetit marrjen parasysh të hartimit të një modeli buxhetimi, ku të angazhohen dukshëm anëtarët e personelit të të gjitha niveleve të organizatës. Ai arriti në përfundimin se **Standardet IV.1-4, Standardi II.2, Standardet V1.1-3, Standardet VII.1-6, dhe Standardet V.1-2 në Kapitullin III** janë përmbushur kryesisht.

Universiteti ofron programe studimi në nivel universitar, pasuniversitar dhe doktore, në përputhje me Strategjinë e tij të Zhvillimit dhe strukturat e fakultetit. Shërbimi është strukturuar siç duhet, si dhe është përafuar me kërkesat e Procesit të Bolonjës dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Universiteti ofron edhe diploma ndërdisiplinore, që synojnë promovimin e veprimtarisë së tij në një kontekst më të gjerë ndërkombëtar. Ofrimi i programeve në gjuhën angleze, sistemi i stazheve, të organizuara nga universiteti për ofrimin e një larmie mundësish për përvojë pune, si dhe sistemi të efektshëm i këshilluesve të studentëve, që mbështesin dhe mbikëqyrin ecurinë dhe arritjet e studentëve me efikasitet, konsiderohen si karakteristika të praktikës së mirë. Universiteti rekruton kryesisht anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, të cilët realizojnë pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore dhe kërkimore. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vërejtë se nuk kishte asnjë sistem të qëndrueshëm dhe të qartë për llogaritjen e lehtësimit të ngarkesës mësimore, gjë që konsiderohet si dobësi. Ai i rekomandon universitetit shqyrtimin e mënyrave për qartësimin e rrugës që ndiqet për lehtësimin e ngarkesës mësimore. Grupi vlerëson se **Standardet I.1-12 të Kapitullit I** janë përmbushur kryesisht.

Përgjegjësitë për menaxhimin e Mësimdhënies, Mësimnxënies, Vlerësimit dhe Kërkimit përcaktohen në Statutin, Rregulloret dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit. Gjatë vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë në këtë fushë. Mosnjohja e strategjisë kërkimore dhe mospërqendrimi te prioritetet kërkimore nga ana e personelit, që kanë karakterizuar ndërmarrjen dhe integrimin e qëndrueshëm të kërkimit në shkallë departamenti dhe qendre kërkimore; vlerësimi i kufizuar i kërkimit në shkallë qendre kërkimore, për shkak të mungesës së pozicioneve të caktuara drejtuese të larta; si dhe mungesa e një mekanizmi për kontrollimin e korigjimit të provimeve, apo standardizimi i vlerësimit me notë i punës së studentëve identifikohen si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon universitetit përgatitjen e një strategjie kërkimore të integruar dhe të përqendruar, ku të përcaktohen qartësisht prioritetet kërkimore të institucionit, që njihen nga stafi, si dhe përgatitjen dhe vënien në punë të mekanizmave për kontrollimin e pyetjeve dhe korigjimit të provimeve për të siguruar zbatimin e duhur të kurrikulës, arritjen e cilësisë dhe përmbushjen e standardit të drejtësisë në korigjimit. Ai pohoi se universiteti po planifikon të përgatisë numrin e nevojshëm të kërkuesve, që do të përqendrohen në disa fusha specifike kërkimore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se **Standardet II.1-4 dhe Standardet I.1-8 të Kapitullit I** janë përmbushur kryesisht.

Universiteti i ofron trupës studentore mbështetje dhe udhëheqje efikase, si dhe një sërë veprimtarish ekstrakurrikulare. Burimet e kampusit universitar përfshijnë: një bibliotekë të pasur, si dhe veprimtari dhe hapësira sportive dhe argëtuese. Ofrimi i hapësirave dhe ambienteve për veprimtaritë sportive dhe mbledhjet e klubit studentor konsiderohen si shembuj të praktikës së mirë. Edhe këshillimi dhe udhëheqja e ofruar nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Zyra e Dekanit të Studentëve, panairët e përvitshme të punës dhe sistemi i bursave të universitetit, që tërheq studentët me rezultatet më të larta, janë shembuj të praktikës së mirë, dhe shërbejnë për përforsimin e punësueshmërisë së studentëve. Nuk u identifikua asnjë dobësi dhe nuk u dha asnjë rekomandim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon ndryshimin e politikës dhe procedurës së pranimit për përmirësimin e aksesit të studentëve me aftësi të kufizuara dhe të përfaqësimit të studentëve në borde përmes Statutit të ri. Grupi arriti në përfundimin se **Standardet e III.1-9 të Kapitullit I** janë përmbushur plotësisht.

## Përmbledhje e gjetjeve

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Bordi i Planifikimit Strategjik mbikëqyr me efikasitet miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Strategjik (pika 1.13; **Kapitulli III Standardi I.5**)
- strukturat e universitetit për mbështetjen e mundësive për stazhe përmes lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partneritetit me punëdhënësit (pika 1.18; **Kapitulli III Standardi III.2** dhe **Kapitulli III Standardi III.3**)
- programi në vazhdim i veprimtarive sociale dhe forumeve të hapura, që mundësojnë njohjen dhe shkëmbimin e ideve ndërmjet personelit (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.2** dhe **Kapitulli III Standardi IV.4**)
- ofrimi i programeve në gjuhën angleze, që nxit punësueshmërinë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare (pika 3.2; **Kapitulli I Standardi I.10**)
- mbështetja individuale e ofruar nga këshilluesit e studentëve në shkallë kursi, lidhur me monitorimin dhe mbështetjen e ecurisë dhe arritjeve të studentëve (pika 3.4; **Kapitulli I Standardi I.8**)
- sistemi i stazheve, të organizuara nga universiteti, që ofron një larmi mundësish për përvojë pune dhe mbështet zhvillimin e punësueshmërisë së studentëve (pika 3.14; **Kapitulli I Standardi I.12**)
- informimi, këshillimi dhe udhëzimi, që i ofrohet studentëve përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Dekanit të Studentëve, janë të qarta dhe proaktive, lidhur me plotësimin e nevojave të studentëve (pika 5.8; **Kapitulli I Standardi III.1** dhe **Kapitulli I Standardi III.3**)
- sistemi i bursave që i ofrohen studentëve me notën më të lartë të përgjithshme mesatare (GPA), veçanërisht për kandidatët që jetojnë në Bashkinë e Vorës, (vendndodhja e universitetit) (pika 5.10; **Kapitulli I Standardi III.4**)
- ofrimi i hapësirave dhe ambienteve për veprimtaritë sportive dhe për mbledhjet e klubit studentor, si dhe nxitja pjesëmarrjes së studentëve në leksionet e mbajtura nga lektorët e ftuar dhe forumeve të hapura (pika 5.13; **Kapitulli I Standardi III.8**)
- organizimi i panairëve të punës, që mbështetet në rrjetin e gjerë të kontakteve të universitetit (pika 5.14; **Kapitulli I Standardi III.9**).

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:



- paqartësia e rrugës që ndiqet në disa raste nga ana e universitetit, për lehtësimin e ngarkesës mësimore, si dhe papërputhshmëritë e mundshme që hasen në shpërndarjen e ekuilibruar të detyrave administrative midis anëtarëve të personelit, që i ngarkohet si detyrë Përgjegjësve të Departamenteve (pika 3.10; **Kapitulli I Standardi I.5**)
- mungesa e mekanizmave për kontrollimin e vlerësimit me notë të tezave të provimeve, kryqëzimin e korrigjimeve dhe standardizimin e punës së studentëve (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- mosnjohja e planeve kërkimore të zhvillimit dhe të integritit, për mbështetjen e qasjeve më të zgjeruara strategjike nga ana e personelit (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4** dhe **Kapitulli II Standardi I.5**).

## Rekomandime

Grupi i Vlerësimeve të Jashtme dha rekomandimet e mëposhtme:

- qartësimi i mënyrës se si llogaritet dhe caktohet lehtësimi i ngarkesës mësimore, për nxitjen e qartësisë në të gjithë universitetin (Prioritet) (pika 3.10; **Kapitulli I Standardi I.5**)
- përgatitja dhe vënia në punë e një mekanizmi të pavarur për kontrollimin e pyetjeve dhe korrigjimit të tezave të provimeve, për sigurimin e zbatimit të duhur të kurrikulës, arritjen e cilësisë dhe përmbushjen e standardit të drejtësisë në korrigjim (Prioritet të lartë) (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- hartimi i një strategjie të qartësisht të përqendruar dhe të integruar nga ana e universitetit, ku të përcaktohen dhe nxiten prioritetet kërkimore për të gjithë personelin (Prioritet të lartë) (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4** dhe **Kapitulli II Standardi I.5**).

## Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- rekrutimi i drejtorëve të rinj të qendrave kërkimore për fillimin e viti akademik 2017-2018 (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.1**)
- rishikimi i anëtarësisë së Këshillit të Etikës, që do të përfshijë përfaqësimin e studentëve, në përputhje me kërkesat e Statutit të ri (pika 1.9; **Kapitulli III Standardi I.1** dhe **Kapitulli III Standardi I.2**)
- përgatitja e numrit të nevojshëm të kërkuesve, që do përqendrohen në fusha specifike kërkimore (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.3**)
- përditësimi i politikës dhe procedurës së pranimit nga ana e universiteti, për përfshirjen e pranimit të studentëve me aftësi të kufizuara (pika 5.9; **Kapitulli I, Standardi III.4**)
- përmirësimi i përfaqësimit të studentëve në komisionet vendimmarrëse (pika 5.12; **Kapitulli I Standardi III.7**).

## **Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi**

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht.**

## **Gjykimi i përmbledhur**

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin “Epoka”, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht.**

## Raporti i detajuar

### Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Universiteti e ushtron veprimtarinë në përputhje me parimet e Statutit të tij, të miratuar për herë të parë në vitin 2017, me themelimin e tij, dhe më pas të ripërshtatur me dispozitat e Ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Përmes misionit dhe objektivave të tij, universiteti angazhohet në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe zhvillim profesional. Duke filluar që nga viti akademik 2017-2018, mësimdhënia nuk do të zhvillohet më në dy fakultete, siç ka ndodhur deri më sot, por në tre. **[13 fq.9; 2 Shënimi 14]** Me hapjen e planifikuar të fakulteti të tretë, Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, institucioni do të përmbushë kërkesat ligjore për statusin e universitetit. Ai ofron programe në te tre ciklet: Bachelor, Master dhe Doktoraturë. **[13 fq.8; 3 Shënimi 13; 2 - Shënimi 14; M1; M3]** **[Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Universiteti i ofron shërbimet e tij përmes Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, dhe Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative. **[1; 3.1]** Universiteti ka edhe dy qendra kërkimore: Qendrën e Studimeve Evropiane dhe Qendrën e Kërkimit dhe Projektimit në Arkitekturë, megjithëse gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit, asnjëra prej tyre nuk kishte drejtor. **[M3; M1]** Universiteti ka edhe Qendrën për Arsim të Vazhdueshëm, që ofron kurse arsimimi dhe formimi, si dhe këshillim për karrierën dhe zhvillimin profesional. **[6.5]** programet ofrohen në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë, dhe ndahen në 10 programe universitare, 17 programe pasuniversitare dhe gjashtë programe doktore, të gjitha me kohë të plotë. Shumica e programeve ofrohen në gjuhën angleze, gjë që rrit kërkesat e studentëve që kërkojnë të punësohen jashtë vendit apo në organizata ndërkombëtare. **[1; M2; M3; 3.6]** **[Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.3 Rregullat dhe rregulloret e universitetit mbështeten në legjislacionin shqiptar dhe në Statutin e vet. Rregulloret drejtojnë proceset dhe produktet e të gjitha njësive dhe shërbimeve të universitetit. **[3 Shënim 11; 3.3]** Statuti miratohet si nga Senati Akademik, ashtu edhe nga Bordi i Administrimit të Universitetit, që aktualisht quhet Këshilli i Lartë, dhe është në përputhje me nenin 33 të ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. **[Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”; 4 Shënimi 12; M2]** **[Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.4 Siç vihet në dukje edhe në pikën 1.2, universiteti ka dy qendra kërkimore, përkatësisht: Qendrën e Studimeve Evropiane, si dhe Qendrën e Kërkimit dhe Projektimit në Arkitekturë. **[1; 3.2]** Duke qenë se drejtorët e qendrave kërkimore nuk ishin caktuar ende, koordinimi dhe drejtimi në të mirën e universitetit dhe personelit të tij, ishin disi të paqarta për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm. Ai **pohon** rekrutimin e drejtorëve të rinj të qendrave kërkimore për vitin akademik 2017-2018 nga ana e universitetit. **[M2; 38; 6.31]** **[Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.5 Universiteti ka organet e duhura të drejtimit, që funksionojnë sipas dispozitave të statutit dhe rregulloreve përkatëse. **[4]** Në proceset vendimmarrëse përfshihen organet kolegjiale si Këshilli i Lartë, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, që janë ristrukturuar së fundmi si Senati Akademik, Bordi i Administrimit dhe Rektori, **[3.2; 3.6; M2]** të cilat ndjekin një qasje nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart për menaxhimin administrativ të çështjeve administrative, financiare dhe studentore, në pajtim me përgjegjësitë dhe detyrat përkatëse, të përcaktuara në Statut. Ata mbledhen rregullisht, ndërsa Rektori monitoron zbatimin e propozimeve të tyre. **[4; 3.1; 3; M3; M5]** Universiteti ka ngritur edhe Këshillin e Etikës, **[14; 14.1]** Këshillin e Profesorëve dhe Këshillin Studentor. **[20.1; 20.3; 37]** Në Bordin e Etikës, ka edhe përfaqësues të trupës studentore. **[M3; M4; M9]** **[Kapitulli III Standardi I.2]**

- 1.6 Sistemi i drejtimit të universitetit i nënshtrohet rishikimit vjetor si përmes kontrolleve të brendshme, ashtu edhe atyre të jashtme, **[6.9 Note 16]** raportet e të cilëve tregojnë se efikasiteti i ofrimit të shërbimeve akademike për studentët është gjithnjë në rritje **[M9; 6.5; 7.2]** Universiteti i ka ndarë qartësisht rolet dhe funksionet, ku struktura e vendimmarrjes lidhur me çështjet administrative, financiare dhe studentore është vertikale. Administrimi i çështjeve akademike dhe kërkimore mbështetet në sistemet vendimmarrëse dhe politikat e përshkruara me hollësi në Statut dhe rregullore. **[3 Shënimi 17; 11; 3 Shënimi 18; M3; M5] [Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.7 Struktura drejtuese e universitetit është tejte e qartë. Autoritetet e tij drejtuese janë: Rektori, Sekretari i Përgjithshëm, dhe Dekanët e Fakulteteve. **[1; 3.2]** Sipas Statutit të ri, vetëm Sekretari i Përgjithshëm do të bëhet Administrator, ndërsa pozicionet e tjera nuk do të pësojnë ndryshime. **[3.1; M3]** Bordi i Administrimit të Universitetit cakton kriteret për alokimin e burimeve, duke përfshirë ato financiare, materiale dhe njerëzore, si dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Lartë, i cili nga ana tjetër, miraton buxhetin dhe planin e investimit. **[10.4; 10.3; 27]** Përpara fillimit të çdo viti akademik, Rektori i kërkon të gjithë departamenteve të përgatisin projektbuxhetet, të cilat, pas rishikimit të Rektorit, i paraqiten për miratim Këshillit të Lartë. **[6 Shënimi 19; 27] [Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.8 Detyrat dhe përgjegjësitë për administrimin janë të përcaktuara qartësisht. Bordi i Administrimit është përgjegjës për ta mbështetur stafin akademik financiarisht, lidhur me pjesëmarrjen në konferenca dhe botimin e artikujve në periodikët ndërkombëtarë të recensuar nga kolegët. **[3 Shënimi 20; 45; 21]** Bordi i Administrimit kryesohet nga Rektori, ndërsa pjesë e anëtarësisë së tij, mandati i së cilës zgjat për dy vjet, janë: Zëvendës Rektori, Dekanët e Fakulteteve, Sekretari i Përgjithshëm, Dekani i Studentëve, Zëvendës Dekani i Studentëve, Përgjegjësi për çështjet institucionale dhe ligjore, si dhe Presidenti i Këshillit Studentor. **[3; 3.1 Statuti; M3; 4; 4.3]** Bordi i Administrimit është përgjegjës për hartimin e planeve afatgjata të zhvillimit, përcaktimin e kriterëve për menaxhimin e burimeve, dhe paraqitjen e tyre për miratim të Këshillit të Lartë. **[3 Shënimi 21 ;M3; 18]** Politikat financiare dhe administrative të universitetit, që janë në pajtim me kërkesat e BE-së, kanë mundur pjesëmarrjen e tij në disa programe të BE-së, duke përfshirë projektet COST, Erasmus+ dhe Horizon 2020, një projekt kombëtar. **[5 Shënimi 42] [Kapitulli III Standardi I.4; Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.9 Senati Akademik është organi më i lartë vendimmarrës kolegjial për sa i përket çështjeve akademike dhe kryesohet nga Rektori. **[3.1; 4; M3]** Senati Akademik është përgjegjës për hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve për të gjitha çështjet që lidhen me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. **[3 Shënimi 22; 4.3; 6.3; 3.1 Statuti]** Këshilli i Etikës është përgjegjës për çështjet etike lidhur me stafin akademik, personelin administrativ dhe studentët, si dhe për t'i paraqitur propozime Rektorit. Statuti i rishikuar e bën të detyrueshëm përfaqësimin e studentëve, dhe duke filluar që prej vitit 2017-2018, anëtarësia e rishikuar e këtij Këshilli do të përfshijë edhe Zëvendës Presidentin e Këshillit Studentor. Mandati i anëtarëve zgjat dy vjet. **[3 Shënimi 23; 14; M3; M1]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon anëtarësinë e rishikuar të Këshillit të Etikës, që do të përfshijë edhe përfaqësues të studentëve, në pajtim me kërkesat e Statutit të rishikuar. **[M3]** Në shkallë fakulteti, Këshilli i Fakultetit, që kryesohet nga Dekani, përcakton të gjitha veprimtaritë lidhur me mësimdhënien dhe kërkimin, në mbështetje të propozimeve të çdo departamenti. Bordi i Administrimit të universitetit është përgjegjës për menaxhimin e burimeve të Fakultetit, bazuar në propozimet e departamenteve. **[3 Shënimi 25; 3.1; 4.11] [Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.10 Statuti i sapomiruar, do të vërë në zbatim një sërë ndryshimesh, duke përfshirë edhe krijimin e Dekanatit, kompetencat e të cilit do të përfshijnë ato të Këshillit të Fakultetit dhe Bordit të Administrimit të Fakultetit. **[3 Shënimi 27]** Krahas kësaj, Asambleja e Stafit Akademik e çdo fakulteti do të përzgjedhë tre anëtarë për në Senat, dhe do të caktojë

anëtarët e komisioneve të përhershme në shkallë fakulteti. **[3 Shënimi 28; M3; M2]** Sipas Statutit të ri, Dekani do të zgjidhet nga Rektori dhe do të miratohet nga Senati Akademik. Mandati i këtyre pozicioneve kyçe do të zgjasë katër vjet, duke filluar që nga viti akademik 2017-2018. **[3 Shënimi 30; M2; M3] [Kapitulli III Standardi I.2]**

- 1.11 Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti drejtues i departamentit, dhe përgjegjës për veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimore të të gjitha niveleve. Aktualisht, Dekani zgjedh si Përgjegjës Departamenti njërin prej anëtarëve të stafit akademik me kohë të plotë, i cili miratohet nga Rektori dhe emërohet nga Këshilli i Lartë. **[3 Shënimi 31; M3; 3.1]** Sipas Statutit të ri, Dekani propozon si Përgjegjës Departamentit dhe Drejtor të Qendrës Kërkimore njërin prej anëtarëve të stafit akademik me kohë të plotë, të cilët emërohen nga Rektori, pas miratimit të Senatit Akademik. **[3 Shënimi 32; 3.7]** Këshilli i Profesorëve e ushtron veprimtarinë në shkallë fakultetit dhe mbikëqyr organizimin dhe drejtimin e programeve të doktoraturës, të ofruara nga universiteti. **[3 Shënimi 33; 4.9] [Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.12 Bordet kryesore të universitetit, të cilat sigurojnë përputhshmëri efikase me rregullat dhe rregulloret e universitetit, përfshijnë: Bordin e Administrimit, Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, dhe Këshillin e Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë (KVAZHC). **[3 Shënimi 39]** Universiteti siguron përfshirjen e të gjithë anëtarëve të personelit në proceset vendimmarrëse të universitetit. **[M9; 11]** Organizohen vazhdimisht mbledhje, për shembull, Këshilli i Lartë mbledhet 11 herë në vit, ndërsa Senati Akademik rreth 15 herë. Personeli njoftohet për të gjitha vendimet e bordeve. **[6.4 Shënimi 35; 3.1; 4.1]** Rektori monitoron procesin e zbatimit kundrejt afateve kohore. **[6 Note 38; M3; M4]** Për mbështetjen e punës së universitetit, përdoret faktori i jashtëm për përmirësimin e organizimit dhe drejtimin e tij, për shembull, KVAZHC-ja përfshin dy konsulentë të jashtëm dhe merr shërbime konsulence nga kompania mëmë. **[3 Shënimi 40/41] [ESG 1.1 Politika për Sigurimin e Cilësisë; Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.13 Universiteti ka mekanizmat e duhura për hartimin dhe rishikimin e Planit të tij Strategjik. Plani i Zhvillimit të Universitetit për periudhën 2013-2017 u hartua për herë të parë, në vitin 2012, për të mbështetur misionin dhe qëllimin e tij. **[7.1 Shënim 43]** Plani, që u diskutua gjerësisht dhe u miratua nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, përcakton objektivat dhe strategjitë e duhura, si dhe identifikon përgjegjësitë kyçe kundrejt objektivave. **[4; M3; 7.2]** Zbatimi i strategjisë monitorohet nga Këshilli i Planifikimit Strategjik, ndërsa ecuria e saj vlerësohet rregullisht nga KVAZHC-ja, në mbështetje të treguesve të përfshirë, që janë përmbushur kryesisht. **[7 Shënimet 45, 46, dhe 47; 7.2]** Aktualisht, Plani Strategjik 2018-2022 është në proces hartimi **[7 Shënimi 48; M3]** Këshilli i Planifikimit Strategjik mbikëqyr me efikasitet miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Strategjik, gjë që konsiderohet si karakteristikë e **praktikës së mirë**. **[M2] [ESG 1.8 Informimi Publikut] [Kapitulli III Standardi I.5]**
- 1.14 Universiteti e publikon dhe ia dorëzon Raportin e tij Vjetor Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. **[7 Shënimi 49]** Raporti i shpërndahet personelit të universitetit dhe palëve të interesit përmes faqes së internetit dhe broshurave. **[6 Shënimi 50 dhe 51; M5]** Raporti është transparent për palët e interesit dhe mbështet vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të universitetit. Ai diskutohet në Senatin Akademik dhe KVAZHC, si dhe ofron monitorim në vazhdim për ecurinë kundrejt përfundimeve të përcaktuara në Planin Strategjik **[3 Shënimi 52; M3]** Faqja e internetit e universitetit ofron informacion të larmishëm si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze që prej vitit 2009, dhe është renditur në vendin e dytë për vite me radhë në Shqipëri, gjë që tregon përshtatshmërinë e informacionit që i ofrohet studentëve dhe palëve të tjera të interesit. **[M6; 13 Shënimi 60 dhe 61] [ESG 1.1 Politika për Sigurimin e Cilësisë; ESG 1.8 Informimi Publikut; Kapitulli III Standardi I.6]**

- 1.15 Universiteti ka strukturat e duhura për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij. Strukturat organizative dhe drejtuese përshkruhen me hollësi në Statutin e Universitetit dhe veprojnë në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar. **[3.1; 3.2]** Senati Akademik vepron me autonomi të plotë, ndërsa personeli gëzon liri të plotë akademike. **[3 Shënimi 53, 54 dhe 55]** Çdo fakultet ka tre njësi bazë, prej të cilave dy janë departamente. Stafit akademik i secilit prej këtyre të fundit përbëhet nga shtatë anëtarë, tre prej të cilëve kanë të paktën doktoraturë dhe një titull të lartë akademik. **[3 Shënimi 58 dhe 59; 3.1; 6.31]** **[Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.16 Të gjithë bordet e universitetit organizojnë forume, për diskutimin e çështjeve përkatëse, ndërsa stafit akademik i jepet mundësia të japë kontributin e tij në proceset vendimmarrëse, në përputhje me Statutin dhe strukturat vendimmarrëse raportuese. **[4 Shënimi 62]** Çdo departament i jep mundësinë stafit të tij akademik të përfshihet në proceset vendimmarrëse. Me hyrjen në fuqi të Statutit të ri, anëtarët e stafit me kohë të plotë do të kenë mundësi të anëtarësohen në Asamblenë e Përgjithshme të Stafit Akademik të çdo fakulteti. **[3 Shënimet 62, 63, dhe 64; 11; M3]** **[Kapitulli III Standardi II.3]**
- 1.17 Të gjitha proceset e universitetit mbështeten në dokumente dhe ndjekin praktikën arsimore dhe administrative të universiteteve partnere. Plani Strategjik i Universitetit bazohet në zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe rolin e arsimit profesional në fushën e arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit dhe teknologjisë së informacionit për zgjerimin e ndërmarrjeve të voglave dhe të mesme. Për të arritur misionin e tij, universiteti ndërmerr kërkime tregu. **[7 Shënimet 65, 66, 67, dhe 68; M2; M3; M7]** Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni ndjekin punësimin e studentëve përmes mbledhjes së të dhënave, të cilat përfshihen në Raportin Vjetor të Universitetit. Prej këtyre të dhënave del se, 75 për qind e të diplomuarve në vitin 2015-2016 kishin gjetur punë brenda vitit të parë pas diplomimit **[51; M9]** Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative raportoi se studentët ishin tejet të kënaqur me perspektivën e punësueshmërisë. **[13 fq. 20 Shënimi 72]** Universiteti konkurren në tregun e arsimit të lartë, duke respektuar kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë. **[13 fq. 20 Shënimet 73 dhe 74; M4; M7]** **[Kapitulli III Standardi III.1]**
- 1.18 Universiteti ka hartuar Strategjinë e tij të Bashkëpunimit për bashkëpunimin dhe partneritetin në shkallë rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, që përfshihet si në Statut ashtu edhe në Planin strategjik 2013-2017. **[7 Shënimet 75 dhe 76; 9]** Prioritetet kyçe të universitetit lidhur me partneritetet përfshijnë: përforsimin e lidhjeve me komunitetin dhe marrëdhëniet me alumni, zhvillimin e bashkëpunimit me industrinë, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhëniet me universitetet brenda dhe jashtë vendit. **[9; 9.5; 9.1]** Universiteti ka lidhur marrëveshje zyrtare me 30 partnerë, që përfaqësojnë një larmi sektorësh të ekonomisë shqiptare. **[9.3; 9.5; M7]** Universiteti është anëtar i asociuar i Shoqatës Evropiane të Universiteteve, si dhe anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Universiteteve. **[<http://iro.epoka.edu.al/home-european-university-association-1141-1636.html>; <http://iro.epoka.edu.al/home-international-association-of-universities-1141-1142.html>]** Marrëveshjet me institucione homologe të arsimit të lartë bazohen në njohjen e përbashkët të kurrikulave dhe lehtësimin e mobilitetit brenda programeve të shkëmbimit të BE-së, si për shembull Erasmus +. **[9 Shënimi 85; M3; M5]** Universiteti bashkëpunon me rreth 50 institucione dhe ndërmarrje për të ofruar stazhe të shumëllojshme dhe lehtësitë përkatëse për mbështetjen e fushave të kurrikulës në shkallë fakulteti. **[9 Shënimi 86/87; 9.4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideron strukturat për mbështetjen e zhvillimit të mundësive për stazhe përmes lidhjes së marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit dhe partneritetit me punëdhënësit si karakteristikë të praktikës së mirë. **[M2; M3; M4; M7]** **[Kapitulli III Standardi III.2; Kapitulli III Standardi III.3]**

- 1.19 Universiteti e nxit mobilitetin e personelit dhe studentëve, si në hyrje, ashtu edhe në dalje në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe përmes mbështetjes financiare. **[13 fq.23]** Universiteti organizon konferenca ndërkombëtare, gjë që përbën prioritet strategjik. Gjatë vitit 2015-2016, personeli i universitetit mori pjesë në 31 konferenca ndërkombëtare dhe 17 aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, shumica e të cilave financoheshin nga universiteti. **[7 Shënime 88-90; 6.5]** Për të gjithë anëtarët e rinj të personelit, duke përfshirë edhe punonjësit, Zyra e Burimeve Njerëzore harton një program të hollësishëm orientimi. **[6.15; M5] [Kapitulli III Standardi III.4]**
- 1.20 Përgjegjësitë për organizimin dhe drejtimin e Universitetit përcaktohen qartësisht në Statutin dhe rregulloret e universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideron strukturat për mbështetjen e zhvillimit të mundësive për stazhe përmes lidhjes së marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit dhe partneritetit me punëdhënësit, dhe Bordin e Zhvillimit të Planit Strategjik, që mbikëqyr me efikasitet miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Strategjik si karakteristika të **praktikës së mirë**. Ai nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk dha asnjë rekomandim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi përfaqësimin e studentëve në anëtarësinë e Këshillit të Etikës, në pajtim me kërkesat e statutit të rishikuar, dhe emërimin e Drejtorëve të Qendrave Kërkimore nga muaji shtator i vitit 2017, për sigurimin e koordinimit dhe drejtimit efikas të kërkimit institucional në shkallë universiteti.

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- mbikëqyrjen efikase të miratimit, zbatimit dhe monitorimit të Planit strategjik nga ana e Bordit të Planifikimit Strategjik (pika 1.13; **Kapitulli III Standardi I.5**)
- strukturat për mbështetjen e zhvillimit të mundësive për stazhe përmes lidhjes së marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit dhe partneritetit me punëdhënësit, (pika 1.18; **Kapitulli III Standardi III.2** dhe **Kapitulli III Standardi III.3**).

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

### Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- emërimi i drejtorëve të rinj të qendrave kërkimore për fillimin e vitit akademik 2017-2018 (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.1**)
- përfaqësimi i studentëve në anëtarësinë e rishikuar të Këshillit të Etikës, në pajtim me kërkesat e Statutit të ri (pika 1.9; **Kapitulli III Standardi I.2**).

## Gjykimi

**Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.**



## Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Rekrutimi i personelit drejtohet nga udhëzimet e përcaktuara qartësisht në Kuadrin Rregullator të Universitetit, dhe menaxhohet në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Kodin e Punës. **[3 Kapitulli 2; 3 Statuti]** Përshkrimet e pozicioneve të punës hartohen qartësisht nga Zyra e Burimeve Njerëzore, në bazë të informacioneve të ofruara nga departamentet dhe të miratuara nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Pagat, pasi rishikohen dhe miratohen nga Administratori, në pajtim me udhëzimet përkatëse, i kalojnë Rektorit për miratim përfundimtar. **[3.8; 24; 6.11; 16]** Si vendet e lira të punës, ashtu edhe informacionet rreth strukturës dhe drejtimit të universitetit, publikohen në faqen e internetit të Epokës. **[6.10; 6.11]** Palët e interesuara plotësojnë formularin online të aplikimit, që gjendet në faqen e internetit, ose mund të kërkojnë informacione shtesë nga Zyra e Burimeve Njerëzore. **[6.1; M3; 24]** Sistemi i pikëzimit përcaktohet në rregullore, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Kodin e Punës 2961/1995, sipas të cilit, pikët jepen në bazë të botimeve akademike dhe kohës kërkimore të shpenzuar jashtë vendit. **[3 Kapitulli 2 Neni 10]** Vendimet përfundimtare merren pas intervistave, ku rekomandimet për emërim i dërgohen rektorit për miratim. **[3.8; 24]** Personat e kualifikuar, të interesuar të punojnë në universitet, ftohen të plotësojnë një formular aplikimi online i cili më pas rishikohet nga departamenti dhe fakulteti përkatës **[faqja e internetit] [Kapitulli III Standardi IV.1; ESG 1.5 Stafi i mësimdhënies]**
- 2.2 Shumica e personelit që punon në universitet, rreth 60 për qind, është i kualifikuar përmes studimeve në institucione jashtë vendit, megjithëse universiteti nuk ka asnjë politikë pozitive për të bërë dallimin midis aplikantëve që janë kualifikuar jashtë, dhe atyre që janë kualifikuar brenda vendit. **[1; M3; 6.11]** Fakultetet dhe departamentet kanë lidhur marrëveshje për mentorimin dhe orientimin e anëtarëve të rinj të personelit, të cilëve iu ofrohet Udhëzuesi i Personelit. **[6.44; M5]** Gjithashtu, punonjësit e rinj kanë akses në broshura dhe informacione të tjera, lidhur me departamentet dhe Qendrat Kërkimore, krahas fakulteteve të universitetit. Anëtarët e personelit nxiten edhe të marrin pjesë në forume të hapura, të cilat i japin mundësinë të diskutojnë rreth zhvillimeve aktuale dhe recensionit të punës kërkimore nga kolegët. **[6.15; 22; 6.5]** Ata njihen me materialet promovuese të programeve, të cilat i ndihmojnë të kuptojnë më mirë shërbimin e universitetit në tërësi. **[22; M5; 9; 6.44]** Për të ndihmuar më tej vendosjen e tyre në universitet, anëtarët e rinj të personelit ftohen në aktivitete sociale, duke përfshirë drekat e mirëseardhjes dhe mbledhjet jozyrtare, për t'i ndihmuar ata të njihen me drejtuesit dhe kolegët, si dhe për të promovuar integritetin në shkallë më të gjerë **[6.15; 6.44]** Ata informohen edhe për planet e zhvillimit profesional dhe strategjisë kërkimore të universitetit, që hartohen si pjesë e Planeve Strategjike në shkallë fakulteti dhe universiteti. **[7.3; 7.1; M3]** Programi në vazhdim i veprimtarive sociale në të gjithë universitetin mundëson njohjen e përgjithshme dhe shkëmbimin e ideve dhe njohurive midis anëtarëve të personelit. Kjo gjë konsiderohet nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si karakteristikë e praktikës së mirë. Të gjithë anëtarëve të personelit i ofrohen sigurime shëndetësore, qofshin këta të punësuar me kohë të plotë, apo me kohë të pjesshme. **[7.3; 6.44; 7.11] [Kapitulli III Standardi IV.2; Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.3 Si për vlerësimin periodik të stafit akademik, ashtu edhe për vlerësimin e performancës së tij ekzistojnë procedura të qarta. Veprimtaritë përfshijnë vëzhgimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe vlerësimin vjetor, që synojnë ta ndihmojnë stafin në vlerësimin dhe përmirësimin e performancës së tyre, dhe të mbështesin zhvillimin e tyre profesional. Për identifikimin e praktikës së mirë dhe fushave kyçe për zhvillimin profesional të stafit si në shkallë individuale, ashtu edhe në shkallë më të gjerë, përdoret edhe feedback-u i studentëve, i përfutur përmes anketimeve. **[3; 6.27; 6.28; 6.29; M5]** Gjatë aplikimeve të stafit për t'u ngjitur në pozicione më të larta, merren parasysh edhe vlerësimet vjetore dhe profilet e performancës. **[6 1.3; 6.30; 6.33]** Sipas rastit, universiteti nxit pjesëmarrjen e personelit në projekte ndërkombëtare dhe veprimtari, duke përfshirë programet universitare në institucionet partnere, veçanërisht në programe evropiane, si pjesë e Planit Strategjik për rritjen e numrit të

anëtarëve të personelit me doktoraturë nga institucionet jashtë vendit. **[7.1; 6.32] [Kapitulli III Standardi IV.3; ESG 1.8 informimi Publikut]**

- 2.4 Personelit i jepet mundësia të punojë me personel ndërkombëtar, të angazhuar në universitet për të ndihmuar në rishikimin dhe mbështetjen e punës me programet e ciklit të tretë dhe për të marrë pjesë në komisionet e vlerësimit. **[6.4]** Për nxitjen e komunikimit të personelit ndërmjet departamenteve, krahas programeve me folës të ftuar dhe hedhjes në treg të librave, organizohen edhe forume të hapura. **[6.5; 9.7; M5]** Personeli mbështetet edhe për të aplikuar për pozicione pune në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës, që mbështetin përpjekjet e tyre për marrjen e titujve “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”. **[6.6; 7.1] [Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.5 Për përcaktimin e përgjegjësive kyçe të roleve kryesore, të cilat fillojnë që nga Rektori, Administratori, Dekanët dhe Përgjegjësit e Departamenteve dhe mbërrijnë deri te stafi akademik, personeli mbështetet, duke përfshirë edhe përshkrimet e pozicioneve të punës, ekzistojnë rregullore të qarta dhe gjithëpërfshirëse. **[3 Seksioni 2 Statuti; 16; M3]** Universiteti ka edhe një kod disipline, që përfshihet në Udhëzuesin e Personelit, Statut dhe rregullore, ku parashikohen sjelljet e pahijshme dhe ndëshkimet e mundshme. **[6.44; 3.1]** Vlerësimi vjetor i personelit i ofron anëtarëve të tij më shumë feedback rreth performancës së tyre, ndërsa rekomandimet për ngritjen në detyrë apo vazhdimin e punësimit bazohen te rezultatet e vlerësimit të performancës. **[39; 6.14] [Kapitulli III Standardi II.2]**
- 2.6 Procedurat e menaxhimit të burimeve financiare përcaktohen në Statut. **[3.1; 4.3; 3]** Përgjegjës për monitorimin e shpenzimeve dhe sigurimin e zbatimit të politikave dhe procedurave përkatëse janë Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyra e Financave. **[3.1; 27; 10.14]** Llogaritë kontrollohen në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, ndërsa raporti i auditit hartohet nga audituesit e pavarur financiarë. **[6.2; M3]** Në Raportin Vjetor, përfshihet edhe përmbledhja e veprimtarisë financiare, që i vihet në dispozicion si personelit, ashtu edhe studentëve, për të siguruar transparencën. **[6.5; M5; 3.8] [Kapitulli III Standardi VI.3]**
- 2.7 Buxheti hartohet nga Rektorati, në mbështetje të informacionit të ofruar, ndërsa diskutimet në shkallë departamenti dhe fakulteti pasqyrohen në planet e miratuara strategjike të çdo departamenti. Bordi i Administrimit të Universitetit, që është organi kolegjal më i lartë vendimmarrës brenda fakulteteve, kryesohet nga Dekani. **[3.3; 7.2 - 7.10; 6.16; M3; M5]** Projektbuxheti i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Financave për rishikim, përpara se t’i kalojnë Këshillit të Lartë të Universitetit për miratim shpenzimesh. **[3; 7.1; 10]** Burimet financiare alokohen në përputhje me vendimet e Këshillit të Lartë, që përfaqëson edhe kompaninë mëmë, pasi universiteti është nën pronësi private, dhe financimi transferohet në shkallë departamenti, nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Financave. Përgjegjës për përputhshmërinë e plotë me kërkesat ligjore, është edhe Këshilli i Lartë. **[4; 3.8; 27] [Kapitulli III Standardi V.1]**
- 2.8 Sistemet e menaxhimit të informacionit dhe sistemet online të informacioneve janë përforcuar së fundmi në një sistem të integruar të quajtur Sistemi Ndërveprues i Epokës (EIS). **[6.5; 10.1; 57]** Sistemi mbështet regjistrimin e të dhënave të studentëve, si dhe i ofron këtyre të fundit dhe personelit akses në shërbimet e studentëve dhe materiale mësimore. **[6.5; M5; M4; M9]** Gjithashtu, sistemi mbështet menaxhimin financiar dhe funksionet e burimeve njerëzore, si dhe mundëson akses të njëtrajtshëm në shkëmbimin e informacioneve në të gjithë universitetin, duke përfshirë edhe lehtësimin e hartimit të raporteve në shkallë departamenti dhe institucionale. **[10.1; 104; 38]** Studentët janë regjistruar në programe dhe module, dhe mund t’i aksesojnë informacionet dhe materialet lidhur me programet që po ndjekin përmes hapjes së llogarive të tyre personale. Ata mund të përdorin edhe llogaritë e EIS-it për marrjen e informacioneve dhe materialeve, si dhe për komunikimin me pedagogët dhe anëtarët e tjerë të personelit. **[10.1; 57; M4; M5; M9]** Personeli mund ta përdorë sistemin për të mbështetur menaxhimin e mësimdhënies dhe atë administrativ, si dhe për kërkimet e

tyre, përmes aksesit në materialet e shkruara dhe linqeve online të bibliotekave të institucioneve të tjera. **[M5; 5.7; 5.11]** Ky sistem mbështet edhe mësimnxënien e kombinuar përmes linkut të platformës elektronike të mësimnxënies. **[10.1; 6.18]** Sistemi i integruar krijon raporte për mbështetjen e menaxhimit të rishikimit dhe vlerësimit të shërbimit, si dhe mund të përgatisë raporte, ku do të bazohen mbledhjet kyçe. **[6.5; 6.18]** **[Kapitulli III Standardi VII.1; Kapitulli III Standardi VII.2; ESG 1.7 Menaxhimi i Informacionit]**

- 2.9 Studentëve iu ofrohet akses në pajisje kompjuterike përmes dy laboratorëve kompjuterikë dhe lidhjes së internetit nëpër klasa. Atyre iu ofrohen edhe printer dhe fotokopje, krahas skanerëve dhe videoprojektorëve. **[10.7; 10.15; Vizita në terren; M4]** Megjithëse nuk ofron asnjë program të të nxënit në distancë, Epoka është në gjendje ta mbështesë ofrimin e mësimnxënies së kombinuar përmes platformës së saj ndërvepruese. **[10 ICT - 1.3.1]** **[Kapitulli III Standardi VII.2]**
- 2.10 Kampusi modern ofron ambiente me hapësira të mjaftueshme për mësimdhënien, mësimnxënien dhe zyrat e personelit. Infrastruktura administrohet nga kompania arsimore “Turgut Ozal”, e cila mban dokumentet lidhur me pronat e paluajtshme dhe godinat e mirëmbajtura. **[10.2; 7]** Sipërfaqja e godinave aktuale arrin në 14,352 m<sup>2</sup>, ku zhvillohen të gjitha veprimtaritë mësimdhënëse, kërkimore, administrative dhe sociale, duke përfshirë edhe një mensë. **[10.8; vizita në terren]** Ndriçimi i auditorëve është i mirë, ndërsa dritaret e mëdha kanë xham të dyfishtë. Të gjitha godinat i përmbushin kërkesat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për ngrohjen, ndriçimin, furnizimin me ujë, akustikën, lartësinë dhe hapësirën. **[23]** Po planifikohet edhe zgjerimi i mëtejshëm i kampusit, për rritjen e kapacitetit në 3,500 studentë në të ardhmen. **[M2; M3; 7]** Përgjegjëse për planifikimin dhe vendimmarrjen lidhur me godinat dhe ambientet është kompania mëmë dhe Këshilli i Lartë i Universitetit. **[4. 4.1 - 4.12; M3]** Universiteti iu vë në dispozicion studentëve ambientet e tij për mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit Studentor, si dhe ambientet sportive në formën e fushave të volejbollit dhe futbollit, së bashku me hapësirat e bollshme të parkimit për studentët dhe personelin. Ai ofron edhe strehim rezidencial në një bllok të veçantë për rreth 100 studentë. **[3.1; 3.3; 4.2; vizita në terren]** **[Kapitulli III Standardi VII.3; Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi V.1]**
- 2.11 Universiteti ka rregulloret e veta për ruajtjen e dokumenteve, të cilat arkivohen. Ruajtja dhe arkivimi i dokumenteve, të cilat mbahen si në format të shtypur ashtu, edhe në format digjital, menaxhohen nga Koordinatorët e Fakultetit dhe Zyra e Regjistrimit. **[8; 2]** Rektorati është përgjegjës për ruajtjen e dokumenteve të mbledhjeve dhe vendimeve kyçe, duke përfshirë edhe ato të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, krahas atyre të studentëve, ku përfshihen të gjitha të dhënat, arritjet dhe diplomat e tyre **[4; 4.3; M1; M3]** Koordinatorët e Fakultetit ruajnë dokumentet e vendimeve dhe mbledhjeve, si dhe mbajnë korrespondencën me organet e tjera. **[3.1; 3.5; M9]** Në fund të çdo vitit, dokumentet arkivohen në përputhje me kërkesat ligjore. Të dhënat përpunohen dhe analizohen nga Njësia e Mbledhjes dhe Analizimit të të Dhënave, e cila i raporton Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë, dhe i vihen në dispozicion në shkallë institucionale bordeve dhe mbledhjeve, sipas kërkesës. **[4; 4.12]** Të dhënat menaxhohen dhe mbrohen në përputhje me ligjin. **[26; 3.8; 4.5; 10.1; 6.18]** **[Kapitulli III Standardi V.2]**
- 2.12 Universiteti ka sisteme të trashëgimisë kulturore për ruajtjen e informacioneve akademike, kulturore dhe shkencore. Dokumentet mbahen në laboratorë, bibliotekë dhe arkivin publik digjital, që është unike për universitetin. **[3]** Kopjet e të gjithë informacioneve rreth syllabusit ruhen së bashku me dokumentet e botimeve të zhvillimeve kërkimore shkencore. **[4.17; 3.1; 3; 6.46]** **[Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi V.2]**
- 2.13 Universiteti Epoka ka sisteme të qarta për menaxhimin e përgjegjësisë së tij për burimet, infrastrukturën dhe nevojat e personelit dhe studentëve. Rekrutimi i personelit kryhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, ndërsa integrimi i anëtarëve të rinj të personelit mbështetet

nga programi në vazhdim i veprimtarive sociale dhe forumeve të hapura, që mundësojnë shkëmbimin e ideve dhe njohjen me njëri-tjetrin, gjë që konsiderohet si karakteristikë e praktikës së mirë. Megjithëse universiteti përdor sistemet e duhura për menaxhimin e të dhënave të tij dhe informacioneve të studentëve, roli i fakulteteve në rishikimin, zhvillimin dhe menaxhimin e buxhetit është i paqartë dhe identifikohet si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon universitetit të marrë parasysh hartimin e një modeli buxhetimi, ku të angazhohen dukshëm anëtarët e personelit të të gjitha niveleve të organizatës.

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- programi në vazhdim i veprimtarive sociale në të gjithë universitetin, që mundëson shkëmbimin e ideve dhe njohurive midis anëtarëve të personelit, si dhe njohjen e përgjithshme me njëri-tjetrin (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.2 dhe Standardi III IV.4**).

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

### Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

## Gjykimi

**Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Universiteti Epoka ka përcaktuar biznesin dhe inxhinierinë si fushat me prioritet të ofertës së tij akademike, të cilat pasqyrojnë objektivat e zhvillimit institucional. [7] Aktualisht, Universiteti ofron 10 programe studimi Bachelor, shtatë Master profesional, nëntë Master shkencorë, një diplomë të integruar dhe gjashtë programe të ciklit të tretë. Fushat e lëndëve përfshijnë inxhinieri kompjuterike, inxhinieri ndërtimi, arkitekturë, ekonomi, bankë dhe financë, administrim biznesi, drejtësi, shkenca politike e marrëdhënie ndërkombëtare dhe shkenca të tjera shoqërore. **[3.8 Statuti (2016) neni 8]** Pjesa më e madhe e programeve janë ofrohen në gjuhën angleze. **[1] [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.2 Programet e studimit përputhen me procesin e Bolonjës dhe legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë dhe janë në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve për të lehtësuar mobilitetin e studentëve. **[3.8 Statuti (2016), Rregullorja bazë; 6.5]** Kriteret e pranimit të përgjithshëm, siç janë niveli i arsimit të mëparshëm, mesatarja e notave dhe niveli i njohjes së gjuhës angleze përcaktohen në Statut dhe në rregullat e pranimeve. Kërkesat e pranimit të studentëve parashikojnë edhe dëshminë e zotërimit të dhe rrjedhshmërisë në gjuhën angleze, dhe studentëve iu kërkohet të bëjnë testin e gjuhës angleze. **[3.8 Statuti (2016) Nen. 83-84-91-95; 3.8 Rregullorja e studimeve dhe provimeve universitare; Shtojca 4; 6.24; 6.25; <http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html> ; T7]** Janë vendosur kritere shtesë sipas kërkesave individuale të programit për të nxënit paraprak dhe nivelin e studimit. Ofrimi i programeve në gjuhën angleze promovon punësimin e studentëve në Shqipëri dhe në nivel ndërkombëtar dhe është një praktikë e mirë. **[Kapitulli I Standardi I.10; Kapitulli I Standardi I.6; Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.3 Universiteti ka procedura të qarta për rekrutimin dhe pranimin e studentëve. Informacioni për programet e studimit iu ofrohet studentëve të ardhshëm dhe palëve të tjera të interesit përmes faqes në internet të Universitetit. Fushatat promovuese organizohen në institucione të arsimit parauniversitar, duke përfshirë shkollat publike dhe private. Universiteti gjithashtu promovon programet e tij përmes pjesëmarrjes në panairë kombëtare të arsimit të lartë dhe përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe broshurave. **[T4; T7; Nr. 59-62 Shembull të fletëpalosjeve dhe broshurave; 6.5; 6.36]** Komunikimet e jashtme me median menaxhohen nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median në përputhje me procedurat e miratuara. **[6.42; M9]** Grupet e nxënësve të shkollave të mesme ftohen të vizitojnë Universitetin ku kanë mundësi të vizitojnë ambientet dhe të marrin informacion më të detajuar nga stafi mbi kurset. Studentët e ardhshëm ftohen të bëjnë një test kompjuterik në gjuhën angleze si pjesë e vizitës së tyre për të siguruar që ata të përmbushin nivelin e njohurive gjuhësore të kërkuara. **[6.34; T7] [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.4 Përmbajtja e programeve të studimit është gjithashtu në dispozicion në faqen në internet të Universitetit, në tabelën e njoftimeve dhe ekrane në kampus, fletëpalosje dhe broshura të vëna në dispozicion si pjesë e Ditës së Orientimit. **[36; T4; T7]** Studentët gjithashtu mund të marrin informacion mbi kurset përmes sistemit të informacionit arsimor të Epokës. **[6.19] [Kapitulli I Standardi I.6]** Studentët marrin informacion kyç për Universitetit, shërbimet dhe lehtësitë e tij me anë të udhëzuesit të studentëve, kontaktit të drejtpërdrejt me tutorët akademikë dhe në Zyrën e Regjistrimit. **[37; 33; T5]** Studentët kanë mundësi të marrin udhëzime dhe mbështetje shtesë përmes kurseve të përmirësimit që ofrohen dhe nga mësuesit personal akademik. Këshilltarët e studentëve gjithashtu janë të gatshëm të diskutojnë probleme dhe të ndihmojnë studentët për të zgjidhur problemet e për të mundësuar përparimin e tyre. **[33; 12; T4]** Ndhimesa individuale që ofrojnë këshilltarët e studentëve, në

- nivelin e kurseve duke monitoruar dhe ndihmuar ecurinë dhe arritjet e studentëve, përfaqëson një **praktikë të mirë**. Rëndësia e ndihmesës që iu ofrohet studentëve dëshmohej në nivelin e përfundimit të kualifikimit të studentëve të diplomuar që është mbi mesataren kombëtare. **[1 Tabela 23, Tabela 30; 6.5] [Kapitulli I Standardi I.8]**
- 3.5 Cilësia e sistemit të vlerësimit të studentëve vlerësohet nga vlerësues të jashtëm dhe raportet tregojnë se kjo funksionon në mënyrë të duhur. **[8.1; 38]** Kriteret e vlerësimit përcaktohen në rregulloret institucionale, ku sistemi i vendosjes së notave bazohet në sistemin e vlerësimit institucional dhe iu njoftohet studentëve në materialet e kursit. **[3.8; 6.46; T4]** Universiteti zbaton sistemin shqiptar të notave dhe përdor sistemin e vlerësimit me kredite ECTS dhe sistemin amerikan. **[3.8 Kapitulli VII]** Kriteret e vendosjes së notave dhe metodat e provimit publikohen paraprakisht në dokumentet e planit mësimor. Në fund të semestrit, në librezën e studentëve regjistrohet mesatarja e notave dhe tregon nëse studenti ka arritur të gjitha rezultatet e të nxënit dhe kriteret e vlerësimit të nevojshme për të ecur përpara dhe për tu diplomuar. Punimi përfundimtar i temës kërkimore është një kërkesë e programeve Master dhe ka kërkesa të qarta për vlerësim dhe notën. Pasi dorëzohet, tema përfundimtare shqyrtohet mes kolegësh. **[4 Vendimi i Senatit Akademik 2.1.7; 80-84 Rivlerësimi i tezës përfundimtare]** Megjithatë, procesi i brendshëm i vendosjes së klasifikimit të notave nuk është gjithmonë transparent, siç diskutohet në pikën 4.2 më poshtë. **[vizita në terren; 52; 54]** Suksesi i sistemit pasqyrohet në vlerësimin e Universitetit krahasuar me institucionet e tjera, gjë që është e rëndësishme për reputacionin dhe aftësinë e tij për të tërhequr studentë. **[6.46; 6.23 Shtojca 1, Statistika, Tabela 25/30]** Procedurat e apelimit të provimit përcaktohet në rregulloren e studimeve universitare **[3.8]. [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.6 Epoka nuk ofron studime me kohë të pjesshme, megjithatë, ofrimi dhe shpërndarja e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë janë përshtatur për të plotësuar nevojat e studentëve që punojnë. **[T4]** Mbi bazë kërkesë të jashtme ofrohen kurse të të nxënit gjatë gjithë jetës nga Qendra e Arsimit të Vazhdueshëm (QAV), një njësi që ofron seminare formuese në arsim dhe teknologji për mësuesit. **[16-23]** QAV-ja ka kapacitet të rrisë kontributin e saj në Politikën institucionale të Zhvillimit të Stafit duke ofruar një sërë programesh formimi për stafin dhe për të diplomuarit. **[T7] [Kapitulli I Standardi I.2; Kapitulli I Standardi I.4]**
- 3.7 Programet e studimit rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe kurrikula përditësohet nga departamenti dhe ekipet e programeve për të ndihmuar progresin dhe punësimin e studentëve. **[6.25; 6.22; Nr 92-100; T1]** Rekomandimet për ndryshime dhe përditësimet të programeve duhet të jenë në përputhje me kërkesat e proceseve të akreditimit dhe ndryshimet e bëra duhet të argumentohen për përmirësimin e kurrikulës. **[T3]** Rezultatet e të nxënit, të një numri programesh në Universitet, përputhen me strategjitë e institucionit për të promovuar punësimin, lidhjet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e bashkëpunimit. **[7,1-7,10; T3; T5; T4]** Shtojca e diplomës paraqet objektiva shtesë të të nxënit, së bashku me kompetencat e fituara që lidhen drejtpërdrejt me rritjen e mundësive për punësim. Diplomat e dhëna dhe shtojcat janë miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe regjistrohet në bazën e të dhënave. **[6.20] [Kapitulli I Standardi I.2; Kapitulli I Standardi I.6; Kapitulli I Standardi I.3; Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.8 Epoka monitoron vazhdimisht programet e studimit për të siguruar që ato të mbeten koherente dhe të reflektojnë nevojat e zhvillimit vendor e kombëtar. **[T2; 7.2]** Programet e studimit përmbajnë materiale që lidhen me aftësi që kërkon tregu i punës dhe kërkesat për njohuri profesionale. **[6,45]** Si programet universitare edhe ato pasuniversitare ofrojnë për studentët praktika ose mundësi punësimi, gjë që nxit punësimin e tyre. **[9.4; T4; 12]** Të gjithë programet e ciklit të parë dhe të dytë

përcaktohen në kredite ECTS, gjë që mbështet transparencën për punëdhënësit, si dhe transferimet dhe progresin e studentëve. **[6.23; 6.46]** Teoritë, parimet dhe aftësitë e buta të përfshira në programe kanë sjellë një shkallë të lartë punësimi të të diplomuarve, duke përfshirë 89 për qind të të diplomuarve në biznes dhe 87 për qind në inxhinieri ndërtimi. **[6.46; 51]** Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Alumni mbledh të dhëna mbi punësimin e studentëve dhe i përfshin ato në raportin vjetor. **[19; M9]** **[Kapitulli I Standardi I.4; Kapitulli I Standardi I.11]**

- 3.9 Universiteti është i angazhuar në zhvillimin e programeve të përbashkëta për të zgjeruar mundësitë e studentëve të tij. Epoka ofron një diplomë të përbashkët me Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Mainz dhe Shkollën e Biznesit EADA. Ky është një tregues i qartë i punës që po kryen Universiteti për të zhvilluar ofrimin e një programi më të gjerë ndërdisiplinor për të rritur profilin e tij dhe mundësitë e studentëve të tij. Universiteti ka zhvilluar edhe programe studimore ndërdisiplinore dhe promovon aktivitetin e tij në një kontekst më të gjerë akademik ndërkombëtar. **[T2; 31; T3; 41.2; 4.16]** **[Kapitulli I Standardi I.4]**
- 3.10 Kuadri ligjor i Epoka-s përcakton qartë rregullat e ngarkesës së mësimdhënies të stafit akademik. Ngarkesa e punës përfshin mësimdhënie, kërkim, mbështetje të studentëve dhe detyra administrative. **[3.8; T5]** Personeli akademik që është angazhuar në detyra administrative ka më pak orë mësimi, por nuk ka udhëzime të qarta për mënyrën e llogaritjes së lehtësimit. Ngarkesa mësimore e programeve të studimit mbulohet kryesisht nga 65 veta staf akademik me kohë të plotë dhe një numër më i vogël lektorësh me kohë të pjesshme. **[1 Tabela 46; 3.3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se baza e llogaritjes së lehtësimit nga orët e mësimi nuk është e qartë në të gjitha rastet. Universiteti thekson se përgjegjësit e Departamentit kanë përgjegjësi të sigurojnë shpërndarje të ekuilibruar të detyrave administrative ndërmjet anëtarëve të stafit, gjë që sjell mospërputhje të mundshme. Këto grupi i vlerësimit i konsideron një **dobësi**. Grupi i vlerësimit **rekomandon** si çështje me prioritet që Universiteti të kërkojë mënyra për ta bërë të qartë mënyrën e llogaritjes dhe caktimit të lehtësimit nga orët e mësimdhënies për të promovuar qartësinë e caktimit të detyrave dhe kërkimit në mbarë Universitetin. **[Kapitulli I, Standardi I.5]** P
- 3.11 Programet e studimeve të ciklit të parë janë hartuar në përputhje me Nivelin 6 të Kuadrit të Kualifikimeve. Ato përqendrohen në disiplina që ofrojnë aftësi profesionale, njohuri bazë të teorive dhe aftësi të avancuara që rrisin aftësitë e zgjidhjes së problemeve, të cilat ndihmojnë në punësimin e studentëve. **[38; 38.1, ECE; 51]** Kuadri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të miratuara nga Këshilli i Administrimit të Fakultetit mbështet mobilitetin. **[3.8]** Sistemi i vlerësimit të notave (GPA) lehtëson procedurat e lëvizjes dhe pjesëmarrjes në programet Erasmus +. **[6.23; T4]** **[Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.12 Universiteti përpiqet të sigurojë që programet e tij të jenë të përshtatshme për qëllimin e kërkuar dhe të reflektojnë praktikën dhe aplikimet aktuale. Programet e ciklit të dytë dhe të tretë përmbajnë njohuri teorike dhe të aplikuara të avancuara; studentët ndihmohen të zhvillojnë aftësitë e tyre kërkimore dhe të kuptuarit mbi bazën e praktikës brenda fushës lëndës. **[3.8; 3.8; 97-100]** Struktura e mësimdhënies dhe aktivitetet e të nxënësve janë projektuar për të kontribuar në arritjet individuale të studentëve dhe kërkimin akademik. Gjithashtu, Universiteti mbështet zhvillimin e stafit dhe studentëve përmes pjesëmarrjeve në seminare, ekspozita, gara, konferenca, udhëtime në terren dhe mundësi të tjera të jashtme. **[3.5; 21; T4; T5]** Grupet kërkimore, në nivel njësie, ofrojnë ndihmesë për studentët pasuniversitarë dhe kontrollojnë nëse përmbajtja e kërkimit ka lidhje me çështjet ose nismat e BE-së, apo nëse mbulon fushat e sipërmarrjeve sociale. **[T5]** **[Kapitulli I Standardi I.9]**



- 3.13 Çdo cikël bazohet në njohuritë e nivelit të mëparshëm dhe transmetimi i njohurive nga cikli në cikël është progresiv. **[3.8]** Merren në shqyrtim etika dhe koherenca e kërkimit me zhvillimin institucional e strategjik. **[7.3]** Pjesë e politikës së Universitetit për zgjerimin e bazës kërkimore dhe zhvillimin e kurrikulës është rekrutimi i stafit të kualifikuar, në veçanti atyre që kanë fituar kualifikime jashtë vendit dhe që kanë tituj akademikë. **[T2; 1 Tabela 3.6, Tabela 33, Tabela 43; 5.3; 5.7]** **[Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.8; Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.14 Formimi profesional është një element përbërës i programeve studimore, në mënyrë të përshtatshme, duke përfshirë aftësi praktike që ndërtohen përmes sipërmarrjes, rasteve studimore, praktikave profesionale dhe stazhit. **[3.8; T4]** Sistemi i praktikave është formalizuar me anë të marrëveshjeve me punëdhënësit. Ai vë në dispozicion një gamë të gjerë mundësish për fitimin e përvojës së punës që mbështet punësimin e studentëve. Këtu përfshihen vendosja në industri, stazhi në banka dhe biznese private dhe praktika tregtare, të cilat studentët pritet t'i kryejnë çdo verë dhe janë një të detyrueshme për përfundimin e kursit dhe të diplomimit. **[6.5; 6.26; 37; T4]** Studentët marrin ndihmesë dhe udhëzime për të gjetur vende të përshtatshme. Gjithashtu, Universiteti përdor alumnit për të zgjeruar rrjetin e tij të vendosjeve në praktika. Vendosjet janë kontrolluar për të siguruar që ata i plotësojnë nevojat e studentëve dhe kërkesat e lidhura me praktikën. **[15; 9.4; T7; T4]** Sistemi i praktikave, i cili ofron një gamë të gjerë mundësish për të marrë përvojë pune, rrit gjasat për punësimin e studentëve dhe përbën një **praktikë të mirë**. **[T7; T4; T6; 14 Ref. Pika 5.22]** **[Kapitulli I Standardi I.4; Kapitulli I Standardi I.12]**
- 3.15 Larmia e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit ndihmon studentët të angazhohen në studimet e tyre; metodat e mësimdhënies përqendrohen në të nxënit që ka në qendër studentin, duke përfshirë punën në grupe, seminare, projekte dhe aktivitete praktike. **[26]** Ekspertë nga profesione të ndryshme ftohen si lektorë, recensues të kurrikulave dhe staf me kohë të pjesshme. **[1 Tabela 30; 38.1; T3; 9.7]** Të gjitha programet universitare dhe pasuniversitare kërkojnë që studentët të dorëzojnë një punim kërkimi ose projekt dhe të bëjnë provimet përfundimtare, si pjesë e vlerësimit të tyre përmblendhës, dhe të dhënat merren nga profesionistët e sektorit përkatës, sipas rastit. **[4.9; 4.19; T4; T5]** **[Kapitulli I Standardi I.8; Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.16 Studentët e Epokës nxiten të marrin pjesë në jetën sociale të Universitetit. Ata kanë mundësi të marrin pjesë në një sërë aktiviteteve, përfshirë këtu aktivitete sportive, forume të hapura dhe klube studentore. **[9.7; 10.11; 12]** Një sërë aktiviteteve sociale janë organizuar për të ndihmuar studentët të përshtaten me Universitetin dhe për të promovuar dhe mbështetur bashkëpunimet e shkëmbimet mes studentëve dhe stafit. Forumet dhe leksionet e hapura iu ofrojnë studentëve dhe stafit mundësi për të zgjeruar njohuritë e tyre në një varg lëndësh dhe nxisin bashkëpunimin dhe punën ndërmjet lëndëve. **[9.7; T4, T6 Ref. Pika 5.17 / 5.18]** **[Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.17 Universiteti ofron programe studimi në nivel universitar, pasuniversitar dhe doktorature, në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe strukturat e fakultetit. Mësimi është i strukturuar në mënyrën e duhur dhe përputhet me kërkesat e Bolonjës dhe kuadrin e kualifikimeve në Shqipëri. Universiteti ka zhvilluar diploma ndërdisiplinore dhe synon të promovojë aktivitetin e tij në një kontekst më të gjerë akademik ndërkombëtar . Ofrimi i programeve në gjuhën angleze, sistemi i praktikave që organizohen nga Universiteti për të ofruar një gamë të gjerë mundësish për marrjen e përvojës së punës, si dhe sistemi efikas i këshilltarëve të studentëve që përkrahin dhe vëzhgojnë në mënyrë efikase ecurinë dhe arritjet e studentëve janë një praktikë e mirë. Universiteti rekruton kryesisht staf akademik me kohë të plotë, i cili merr shumicën e ngarkesës së mësimdhënies dhe kërkimit. Megjithatë, grupi i vlerësimit

vuri në dukje se nuk ka një sistem të qartë e të qëndrueshëm për llogaritjen e lehtësimit të orëve të mësimdhënies, gjë që është një dobësi. Grupi i vlerësimit rekomandon që Universiteti të kërkojë mënyra për ta bërë të qartë mënyrën e lehtësimit nga orët e mësimdhënies.

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- ofrimi i programeve në gjuhën angleze promovon aftësimin e studentëve për tu punësuar në Shqipëri dhe në nivel ndërkombëtar (pika 3.2; **Kapitulli I Standardi I.10**)
- ndihmesa individuale që ofrojnë këshilltarët e studentëve, në nivelin e kurseve duke monitoruar dhe mbështetur ecurinë dhe arritjet e studentëve (pika 3.4; **Kapitulli I Standardi I.8**)
- sistemi i praktikave, i organizuar nga Universiteti, ofron një gamë të gjerë të mundësish për të marrë përvojë pune, gjë që ndihmon në rritjen e gjasave për punësimin e studentëve (pika 3.14; **Kapitulli I Standardi I.12**).

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- baza e llogaritjes së lehtësimit nga orët e mësimdhënies nuk është e qartë në të gjitha rastet. Universiteti thekson se përgjegjësit e Departamentit janë përgjegjës për sigurimin e shpërndarjes së ekuilibruar të detyrave administrative tek anëtarë e stafit, gjë që sjell mospërputhje të mundshme (pika 3.10; **Kapitulli I Standardi I.5**).

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti duhet të qartësojë bazën e llogaritjes dhe caktimit të lehtësimit nga orët e mësimdhënies për të promovuar qartësi në mbarë Universitetin (prioritet) (pika 3.10; **Kapitulli I Standardi I.5**).

### Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces.

### Vlerësim

Standardet për kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

## Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Universiteti vepron mbi bazën e një game të plotë rregullash e procedurash të përcaktuara në Rregulloren e studimeve dhe provimeve universitare, Rregulloren e programeve të ciklit të dytë të studimeve dhe për programet e studimeve të doktoraturës. **[3 Shënimi 234; 4.19]** Të gjitha rregulloret janë publikuar në faqen në internet të Universitetit dhe i komunikohen gjithë stafit përmes kanaleve zyrtare. **[3.2]** Bordet e Fakultetit mbikëqyrin praktikën dhe vëzhgojnë dorëzimin e temës, projektet e studentëve, detyrat e seminarit, punën praktike dhe kërkimore. **[3.3; T3; T5]** Biblioteka e Universitetit ofron literaturën mbështetëse për të gjitha programet e studimit. Ajo ka gjithsej 10,000 libra në format të shtypur si dhe një varg burimesh online. **[10.10; 12; T2; T4]** **[Pranimi, ecuria, njohja dhe certifikimi i studentëve 1.4; Kapitulli I Standardi II.1]**
- 4.2 Kriteret dhe procedurat e diplomimit publikohen në faqen në internet të Universitetit sipas rregullave të programeve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. **[13 fq. 51, Shënim 240/241/241]** Universiteti përdor një sërë metodash provimi, duke përfshirë testet, provimet me gojë e me shkrim. **[3.3; T3]** Ka një procedurë ankimi për të mbrojtur objektivitetin e vlerësimit. **[3.1; 3.3]** Çdo student në kohën e regjistrimit pajiset me një llogari konfidenciale në internet, e cila regjistrohen të gjitha programeve të studimit dhe njofton studentin për rezultatet nga secili vlerësim. **[T5; 6.19]** Mbi bazën e shqyrtimit të disa provimeve dhe nga diskutimet me Universitetin, u bë e qartë se ka një mungesë të mekanizmave që bëjnë kontrollin e vendosjes së notave, moderimin dhe marrjen e mostrave të punës nga Përgjegjësi i Departamentit ose nga Komisioni i Provimit, gjë që grupi i vlerësimit e konsideron si **dobësi**. **[52; 54]** Grupi i vlerësimit **rekomandon** si një çështje me prioritet të lartë që Universiteti të zhvillojë dhe zbatojë një mekanizëm të pavarur për të kontrolluar pyetjet e fletëve të provimeve dhe vendosjen e notave të provimeve, për të siguruar mbulimin e duhur të kurrikulës dhe cilësi e drejtësi në vendosjen e notave. **[13 fq. 52 Shënim 244; 54]** **[Pranimi, ecuria, njohja dhe certifikimi i studentëve 1.4; Kapitulli I Standardi II.2]**
- 4.3 Secili fakultet merr feedback si nga kolegët edhe nga studentët për të siguruar që mësimdhënia dhe mësimnxënia e ofruar të jenë të cilësisë më të lartë. Në këtë drejtim, çdo semestër, Universiteti kryen vlerësimin nga studentët dhe publikon rezultatet e vlerësimeve të studentëve në raportin e tij vjetor. **[6.5; 6.29; 6.28; 40]** Raporti vjetor përfshin gjithashtu rezultatet e provimeve hyrëse, konkurset dhe arritjet. **[6.5]** Vlerësimet nga ana e stafit dhe nga studentët përdoren për të mbledhur informacion dhe përmirësuar koherencën e programeve të studimit. **[3.3; 6.5; 6.24; 40]** Gjithashtu, objektivat e programit dhe kurrikulat rishqyrtohen mbi bazën e statistikave të punësimit të studentëve, të raportuar në nivel departamenti. Punësimi i suksesshëm i studentëve është një faktor kyç përcaktues i zhvillimit të programeve Master. **[38; T3; T4; 19]** **[SUE 1.3 Të nxënit, mësimdhënia dhe vlerësimi me në fokus studentin; Kapitulli I Standardi II.3]**
- 4.4 Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë (KVAZHC) monitoron zbatimin e rregulloreve të programit dhe të cilësisë së përgjithshme të mësimdhënies në nivel Universiteti. Fakulteti dhe departamentet me anë të komisioneve të vlerësimit bëjnë vlerësimin e kolegëve dhe gjykojnë vlerësimet e studentëve. **[3.3; 38; T3]** Fakultetet nuk e kanë përfshirë ende gjykimin e efektshmërisë të mësimdhënies në procesin e vlerësimit të stafit, megjithëse broshura e re e udhëzuesit të stafit konfirmon se kjo gjë duhet të jetë një faktor parësor në vlerësim. **[38; 19]** Universiteti beson se cilësia e mësimdhënies është me prioritet, megjithatë, Universiteti konfirmon se udhëzuesi i ri i stafit nuk do të zbatohet deri në vitin 2017-2018. **[13 fq. 53, Shënim 252; T3]**

Studentët dëshmojnë nivel të lartë kënaqësie me cilësinë e mësimdhënies në vlerësimet e tyre vjetore. [12; T3; T4] Universiteti mbështet stafin të fitojë kualifikime të mëtejshme, si dhe siguron fonde për botimet e punimeve kërkimore dhe pjesëmarrje në konferenca e seminare. [13 fq. 54, Shënim 253/254/255/256/257; 5.1; 5.5; 5.8] [SUE 1.9 Monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi periodik i programeve; Kapitulli I Standardi II.4]

- 4.5 Departamenti është njësi bazë mësimore dhe kërkimore e Universitetit. Ka tetë departamente dhe një qendër kërkimore, si një njësi bazë e përqendruar në mësimdhënie dhe kërkime në fushën e shkencave politike, ekonomike, drejtësisë, biznesit, projektimit dhe inxhinierisë. Departamentet veprojnë me grupet kërkimore, të cilat funksionojnë në çdo njësi kërkimore, me 56 zona kërkimi të raportuara, 26 prej të cilave lidhen me Departamentin e Administrimit Biznesit. [5.1; 41.4; 6.32; 6.5] Komisionet e publikimit, promovimit dhe aktiviteteve Shkencore i konvertojnë arritjet e kërkimit në pikë dhe i mbulojnë stafit shpenzime për të kryer kërkime. [5.5; 44] Kërkimet vlerësohen në nivel departamenti dhe gjykohen gjithashtu nga Zyra e Kërkimit dhe Projekteve dhe Këshilli KVAZHC. [T3; 4.5] Universiteti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 40 universitete në 20 vende dhe numri mesatar i botimeve të stafit akademik që nga viti 2011 ka qenë 84 botime në çdo vit. [5.3; 9.1] Pjesëmarrja e stafit në aktivitete shkencore ndërkombëtare mbulohet financiarisht nga Universiteti. Norma mesatare është 10-15 ngjarje në vit. [5.8] Qysh prej vitit 2011, janë botuar 11 libra dhe 423 punime shkencore e artikuj revistash nga stafi me kohë të plotë. [5.3; 6.5] [Kapitulli II Standardi I.1]
- 4.6 Kërkimi shkencor kryhet në nivel departamenti, siç përcaktohet në statut dhe në Ligjin për arsimin e lartë, [3.1] dhe organizohet brenda disiplinave kërkimore specifike. [13 fq. 56, Shënimi 263] Megjithatë, Universiteti thekson se, për të arritur në një numër të rëndësishëm kërkuesish, duhet të përqendrohet në një numër më të vogël fushash kërkimore. [6.5; T2; 5.1] Grupi i vlerësimit **pohon** se Universiteti ka hartuar plane për të arritur një numër të rëndësishëm kërkuesish, në mënyrë që të përqendrohet në një numër më të vogël fushash kërkimore. [T2] Mbështetja financiare për kërkime i paraqitet Senatit Akademik dhe miratohet nga Këshilli i Administrimit. Fakulteti dhe Këshilli i Administrimit mbajnë përgjegjësi financiare. [56; 10.14; 27] Mbështetja financiare e dhënë nga Universiteti ka bërë që të rriten rezultatet kërkimore, duke përfshirë konferencat, botimet dhe mobilitetin e stafit. Që nga viti 2011, numri mesatar i botimeve vjetore është qenë 84 (1.36 për FTE), ndërkohë 10-12 për qind e buxhetit të Universitetit shkon për kërkimin. [5.1; 5.3] Pavarësisht se Universiteti ka kërkuar në mënyrë aktive marrëveshje dypalëshe me universitete të huaja dhe një ka bërë një numër aplikimesh për fonde kërkimore, ndërmjet vitit 2012 - 2015 numri i autorëve të botimeve ka rënë nga 2.2 në 1.3. [13 fq. 58, Shënimi 270; 6.5] [Kapitulli II Standardi I.2]
- 4.7 Për të rritur vizibilitetin e gjetjeve të kërkimit, Universiteti organizon takime ceremoniale, ku anëtarët e fakultetit kanë mundësi të publikojnë kërkimet e tyre. Megjithatë, Universiteti raporton se këto aktivitete janë disi të rastësishme ose jo formale dhe do të dëshironte t'i formalizonte ato në të ardhmen. [13 fq. 60, Shënim 281; 5.1; 6.5] Për të nxitur debatin mes anëtarëve të fakultetit, Universiteti organizon leksione të hapura me kërkues të njohur, forume të hapura me personalitete shqiptare, takime ceremoniale dhe botime librash. [9.7; 13 fq. 61, Shënim 285/286; 6.5; T5; T4] [Kapitulli II Standardi I.3]
- 4.8 Prioritetet e kërkimit të Universitetit lidhen me shkencat e aplikuara, inxhinieri, projektim, biznes, drejtësi dhe shkenca shoqërore. Prioritetet e kërkimit, së bashku me disa tregues të matshëm, përcaktohen në fusha të gjera në Planin Strategjik dhe Strategjinë e Kërkimit. [41.1; 41.2; 41.3; 41.4] Ndër objektivat përfshihen rritja e

bashkëpunimit me organizata kërkimore kombëtare dhe e numrit të aplikimeve për projekte kërkimore kombëtare. Nga shqyrtimi i dokumenteve dhe diskutimet me stafin akademik, u vu re se Prioritetet e kërkimit të Universitetit janë të gjera, por mungon qartësia, dhe ato nuk kuptohen e përvetësohen mirë nga stafi që grupi i vlerësimit takoi. **[41.1; 41.4; T3; T5]** Grupi i vlerësimit doli në përfundimin se mangësia e stafit lidhur me kuptuarin e planeve të Universitetit për zhvillimin dhe integrimin e kërkimit, në mbështetje të një qasje më të gjerë strategjike është një **dobësi**. Grupi i vlerësimit **rekomandon** si një çështje me prioritet të lartë që Universiteti të hartojë një strategji kërkimi të qartë, të përqendruar dhe të integruar, e cila të artikulojë dhe promovojë Prioritetet e tij kërkimore për të gjithë stafin. Për më tepër, siç u theksua në pikën 1.4, nuk ka strategji apo mekanizëm për vlerësimin e rezultateve kërkimore për shkak se nuk janë emëruar drejtorët e Qendrave Kërkimore, gjë që ka penguar Universitetin të përqendrohet në kërkime. **[3.2; 13 fq. 62, Shënimi 293/294; T3] [Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5]**

- 4.9 Universiteti ka qenë aktiv duke u angazhuar në zhvillimin e politikave kombëtare të kërkimit shkencor dhe politikave kombëtare të arsimit të lartë në nivel institucional dhe individual. Universiteti jep rregullisht mendime Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe harton procese për zhvillimin e strategjive sektoriale. **[T7; 5.1; 6.5]** Strategjia kërkimore përfshin disa nga çështje me prioritet të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009-15. **[6.13]** Universiteti fton rregullisht staf akademik të huaj që të veprojnë si lektor të ftuar apo të kryejë kërkime me qëllim promovimin e ndërkombëtarizimit të programeve studimore. **[5.1; 5.5; 45; T5]** Kandidatët për doktorantë zgjedhin temat e tyre kërkimore duke marrë parasysh fushat kërkimore të secilit departament. Më pas kërkimi i tyre integrohet në grupe kërkimore që u lejon studentëve të doktoraturës të bëjnë publikime së bashku me mbikëqyrësit e tyre. **[T5; 5.3; T2; T5]** Universiteti nxit studiuesit e rinj të përfshihen në projekte kërkimore dhe të publikojnë dokumente në bashkëpunim me stafin. **[T4; T5; 6.5] [Kapitulli II Standardi I.6; Kapitulli II Standardi I.8]**
- 4.10 Universiteti ka zhvilluar një kuadër rregullator kërkimor për aktivitetet e botimit. **[41.4]** Rezultatet e kërkimit ruhen në faqet në internet të departamenteve dhe ngarkohen në bazën digjitale të Universitetit. **[57 Demonstrim i mjedisit virtual të të nxënit; T5]** Universiteti ka hartuar gjithashtu një politikë të pronësisë intelektuale dhe është në proces hartimi të një Kodi Etik që mbështet stafin akademik dhe personelin administrativ, përfshirë edhe studentët. **[14; 3.3] [Kapitulli II Standardi I.7]**
- 4.11 Monitorimi i kërkimeve zhvillohet në nivel departamenti dhe fakulteti, si dhe nga Zyra e Kërkimit dhe Projekteve, e cila siguron koordinimin dhe përdorimin efikas të burimeve. Rezultatet e kërkimit vlerësohen nga Këshilli KVAZHC. **[41.2; 41.3]** Universiteti në mënyrë rigorozë vepron në pajtim me dispozitat e rregullores për etikën në kërkime dhe veprimtaritë botuese. Të gjitha punimet, artikujt dhe disertacionet e përgatitura nga studentët i nënshtrohen testimit të plagjiaturës, duke përdorur Turnitin, një program për zbulimin e plagjiaturës. **[3.3; T4; T5]** Në faqen e tij në internet, Universiteti publikon tekstet e plotë të të gjitha disertacioneve të doktoraturës që janë mbrojtur nga doktorantët përpara jurisë së ngritur nga Këshilli i Profesorëve. **[faqja në internet; T3; T5] [Kapitulli II Standardi I.8]**
- 4.12 Përgjegjësitë për menaxhimin e mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit janë përcaktuar qartë në statutin e Universitetit, rregulloret dhe strategjinë e kërkimit. Grupi i Vlerësimi të Jashtëm nuk identifikoi asnjë tipar të praktikës së mirë në këtë fushë vlerësimi. Dobësi u identifikuan edhe në zotërimin nga ana e stafit të strategjisë kërkimore të Universitetit dhe fokusit të prioritetëve kërkimore, gjë që kanë penguar zhvillimin dhe integrimin e kërkimeve të qëndrueshme në nivel e departamenti dhe të qendrës kërkimore; vlerësim të kufizuar të kërkimeve në nivel qendrash kërkimore për

shkak të mosemërimit të drejtorëve; dhe fakti që nuk ka një mekanizëm të pavarur për të kontrolluar vlerësimin me nota të punimeve, apo standardizimin në vlerësimin me nota të detyrave të studentëve. Grupi i vlerësimit rekomandon që Universiteti të hartojë një strategji kërkimore të integruar dhe të përqendruar, e cila të artikulojë qartë Prioritetet e kërkimit të Universitetit në mbarë institucionin dhe të zotërohet nga stafi; si dhe të hartojë e zbatojë një mekanizëm të pavarur për të kontrolluar pyetjet e fletëve të provimeve dhe vlerësimin me nota të provimeve për të siguruar mbulim të përshtatshëm të kurrikulës dhe cilësi e drejtësi në vlerësimin me nota. Grupi i vlerësimit pohon se Universiteti po planifikon të sigurojë një numër të përshtatshëm kërkuesish, në mënyrë që të përqendrohet në një numër më të vogël fushash kërkimore.

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e mekanizmave të kontrollit të vlerësimit me nota të punimeve, moderimit dhe marrjes së mostrave të punës (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- mangësia e stafit për të kuptuar planet e Universitetit për zhvillimin dhe integrimin e kërkimit, për të mbështetur një qasje më të gjerë strategjike (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4** dhe **Kapitulli II Standardi I.5**).

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- të hartohet dhe zbatohet një mekanizëm i pavarur për kontrollimin e pyetjet e fletëve të provimeve dhe vlerësimin me nota të provimeve për të siguruar mbulim të përshtatshëm të kurrikulës dhe cilësi e drejtësi në vlerësimin me nota. (prioritet të lartë) (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- Universiteti duhet të hartojë një strategji kërkimi të qartë, të përqendruar dhe të integruar, e cila të artikulojë dhe promovojë Prioritetet e tij kërkimore për të gjithë stafin (prioritet të lartë) (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4** dhe **Kapitulli II Standardi I.5**).

### Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet në proces si më poshtë:

- Universiteti ka hartuar plane për të siguruar një numër të përshtatshëm kërkuesish në mënyrë që të përqendrohet në një numër më të vogël fushash kërkimore (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.2**).

### Gjykimi

**Standardet për Mësimdhënien, Mësimdhënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.**



## Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Universiteti ka mekanizma dhe procedura të qarta për pranimin e studentëve. Epoka e ka harmonizuar politikën e saj të pranimit me strategjinë afatmesme të zhvillimit institucional (2017-22). Strategjia përcakton menaxhimin e shërbimeve për alumnit dhe punësimin e tyre të mëvonshëm. [7.1 fq. 7-84; T4; 6.43] Procedurat e pranimit mbështeten nga kuadri rregullator i Universitetit. [3.1; 8; 2.3; 6.35] Ndhimesa dhe shërbimet që ofron Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit dhe Shoqata e Alumnit mbështeten edhe nga marketingu me fonde të caktuara. [6.36; 3.8; 3.1 Neni. 8; T7] Fletëpalosje dhe broshura të shtypura iu dërgohen kandidatëve gjatë fushatës promovuese dhe pas regjistrimit të tyre. [59-62] [Kapitulli I Standardi III.I; Kapitulli I Standardi III.3]
- 5.2 Epoka harton një program planifikimi të karrierës për të tërhequr studentë të ardhshëm nga institucionet e arsimit parauniversitar dhe dërgon informacion tek Drejtoritë Arsimore Rajonale në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. [3.36; T7] Çdo vit, në kampusin e Universitetit, organizohen ditë të hapura dhe panairë edukative dhe Universiteti merr pjesë në panairët kombëtare për arsimin e lartë. [3.5; T7] Faqja në internet e Universitetit paraqet informacion rreth procedurave të regjistrimit dhe kurrikulën e programeve të studimit, si dhe objektivat e të nxëniet. [Faqja në internet, T7]
- 5.3 Mbështetja për studentët e rinj menaxhohet në mënyrë efikase. Udhëzuesi i studentëve dhe Dita e Orientimit ndihmojnë në integrimin e studentëve të rinj në Universitet. [37; 50] Studentët e huaj ndihmohen të gjejnë akomodim dhe marrin këshilla për të siguruar plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim. [T7; 37; 6.5; 12] Oraret e takimeve, seminarët informuese dhe adresat elektronike të stafit administrativ janë gjithashtu në dispozicion për të ndihmuar studentët. Këshilltarët akademik dhe grupet/klubet studentore të ndihmës ofrojnë ndihmesë për studentët e sapo regjistruar. [T4; T5] [Kapitulli I Standardi III.1; Kapitulli I Standardi III.2]
- 5.4 Zyra e pranimit udhëzon dhe monitoron gjithë procesin e integritit dhe dokumentacionin dhe është e hapur gjatë gjithë vitit. [6,43] Zyra e Sekretarisë është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave të studentëve dhe dosjeve individuale, në përputhje me aktet nënligjore për mbrojtjen e të dhënave. [3.8 Neni 27; T7; 3.5] Dosja përfshin një kontratë studimi, [6.37] detajet e provimit të njohjes së gjuhës angleze, diplomën e maturës shtetërore, notat, dokument identifikimi, si dhe të dhënat personale, dokumentacionin e para diplomimit, notat e universitetit dhe shtojcat e diplomës. Zyra gjithashtu ruan për një vit të gjitha raportet e vlerësimit të dorëzuara, të cilat më pas i dërgohen arkivit të institucionit. [3.3; 3.5; T7] [Kapitulli I Standardi III.1; Kapitulli I Standardi III.2]
- 5.5 Universiteti sigurohet që studentët të marrin mësimin dhe mbështetjen e duhur akademike. Raporti staf student është një anëtar stafi akademik për çdo 17 studentë. Ky raport është brenda kërkesave ligjore. [5.2; 3.1.2 tabela 38] Raporti mesatar i asistentëve kërkimor dhe mësimor dhe student është një me 34, në vitin 2015-2016. [1 tabela 39] [Kapitulli I Standardi III.1]
- 5.6 Universiteti organizon komunikimet e tij të brendshme dhe të jashtme për të ndihmuar studentët dhe për t'u angazhuar me aktorë të tjerë. Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median menaxhon komunikimet e jashtme me median dhe siguron mbulimin e aktivitetit akademik dhe kërkues. [6.1 fq. 193-3; 6.42] Komunikimi i brendshëm në aspektin e shpërndarjes së informacionit nga lart-poshtë dhe shpalljeve bëhet në formë të shkruar dhe vihet në dispozicion të stafit dhe

- studentëve në mënyrë elektronike, sipas rastit, përmes adresave elektronike përkatëse të universitetit. [T4; T5; T7; 37] Universiteti ruan të dhënat e adresave elektronike zyrtare të Universitetit dhe numrat e telefonit të stafit akademik dhe studentëve. [6.41; T3; T7] Studentëve iu jepet një udhëzues për studentët, i cili përmban informacion kyç dhe detaje të kontaktit, si dhe këshilla dhe udhëzime që mund të jepen nga zyra e Dekanit të Studentëve. [37; 3.9; T7] **[Kapitulli I Standardi III.2]**
- 5.7 Programet e studimeve të vitit të parë përbëhen nga orët e prezantimit dhe kurset me zgjedhje dhe ndihmojnë studentët për të vendosur për studimet e tyre. Tutorët dhe këshilltarët akademikë vëzhgojnë ecurinë e studentëve dhe ofrojnë mbështetje dhe këshilla akademike. [6.46; 6.38; T4; T5; T7; 3.8] Gjithashtu ofrohet këshillim dhe udhëzim për përzgjedhjen e programeve studimore, në përputhje me aftësitë e kandidatit. Këshilltarët studentorë ndihmojnë studentët të organizojnë planin e tyre arsimor sipas aftësive dhe interesave të tyre. [T5; 3.4; 6.37; 6.40]
- 5.8 Udhëzimet për transferimin e studimeve dhe procedurat e transferimit të krediteve janë përcaktuar qartë në procedurat dhe rregulloret e Universitetit. [3.9 Udhëzimi për transferimin ndërmjet departamenteve; 3.8; T4] Zyra e Dekanit të Studentëve ofron këshilla dhe udhëzime mbi karrierën dhe punësimin, ndihmon e këshillon për gjetjen e akomodimit, ndryshimin e kurseve, si dhe jep këshilla për çështje financiare. Studentët gjithashtu mund të kërkojnë këshilla dhe ndihmesë për çështje shëndetësore, në rast se ato mund të mos ofrohen nga mjeku i kampusit. Studentët konfirmuan se këshillat dhe udhëzimet që marrin janë të qarta dhe të kuptueshme, si dhe se që mund të diskutojnë për çdo çështje emocionale dhe nevoja shtesë dhe marrin ndihmën e kërkuar. [3.5; 3.1; 3.3; T3; T7; T4] Të gjitha shërbimet e ofruara për studentët monitorohen dhe ndërmjetësohen nga Dekani i Studentëve. [3.4; 3.1; T7] Kjo zyrë gjithashtu menaxhon programet e mentorimit dhe koordinon caktimin e tutorëve sipas departamenteve për studentët që kanë vështirësi në përmbushjen e kërkesave të kursit. [6.10; T4; T7] Informacioni, këshillat dhe udhëzimet që u ofrohen studentëve përmes Zyrës së Karrierës dhe Dekanit të Studentëve janë të qarta dhe në përgjigje të nevojave të studentëve. Grupi i vlerësimit e konsideron këtë gjë një praktikë të mirë. [16] **[Kapitulli I Standardi III.1; Kapitulli I Standardi III.3]**
- 5.9 Epoka nuk ka një politikë formale për mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara. Një nga ndërtesat kryesore është e aksesueshme përmes një rampe dhe ka një ashensor për tu ngjitur në katet e larta. [vizita në terren; 38] Mensa e studentëve dhe mjediset sociale të vendosura në godinën e dytë kryesore janë në katet e para dhe të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara fizike. Megjithatë, biblioteka, e vendosur në katin e dytë, nuk mund të aksesohet. [T7; vizita në terren] Epoka planifikon të ndryshojë politikën e saj të pranimit për të përfshirë studentët me aftësi të kufizuara në vitin e ardhshëm akademik. Grupi i vlerësimit pohon se Universiteti ka përditësuar politikën dhe procedurat e tij të pranimit për të përfshirë pranimin e studentëve me aftësi të kufizuara. [4.18; T7] **[Kapitulli I Standardi III.4]**
- 5.10 Bursat u ofrohen studentëve me status të veçantë, duke përfshirë romët dhe egjiptianët e Ballkanit, fëmijët e oficerëve të policisë të rënë në krye të detyrës dhe jetimët nga familjet me të ardhura të ulëta. Universiteti gjithashtu ofron bursa për studentët me mesatare të lartë të notave të shkollës së mesme dhe për studentët që shkëlqejnë në sporte. [4.4; 4.18] Sistemi i bursave që ofrohen për studentët me mesatare të lartë, veçanërisht për kandidatët që jetojnë në Bashkinë e Vorës (vendndodhja e Universitetit), është një shembull i praktikës së mirë me anë të së cilës një Universitet privat është i aftë të tërheqë studentë me arritje të larta dhe të vazhdojë të përforcojë shërbimin e tij. **[Kapitulli I Standardi III.4]**

- 5.11 Biblioteka e Epokës ka një stok prej 10,000 libra të shtypur, të cilët janë vendosur në një listë digjitale. Katalogu mund të gjendet në faqen e internetit të Universitetit. [<http://lib.epoka.edu.al/>] Librat janë të disiplinave të ndryshme dhe lidhen me fushat e lëndëve dhe gjithashtu ofrohen edhe libra letrarë. Biblioteka ruan punimet e diplomimit dhe doktoraturës së studentëve. Gjithashtu, biblioteka ofron akses në 16 burime kërkimi online, së bashku me aksesin në internet. **[3.9; 49]** Fondi i bibliotekës pasurohet me fonde buxhetore për blerje librash, në përputhje me kërkesat e departamenteve. **[4.15]** Orari i punës së bibliotekës është 8:30 - 17:30, gjatë ditëve të javës, dhe 09:00 -13:00 të shtunave, **[vizita në terren]** dhe hollësitë publikohen në faqen e internetit. Studentët përdorin kartën e tyre të studentit për të pasur akses në burimet e bibliotekës. **[6.39; T4]** Burimet e bibliotekës vihen në dispozicion me anë të një sistemi me vetëshërbim dhe bibliotekarët ofrojnë ndihmesë që studentët të kenë akses në literaturën e duhur. **[3.9; vizita në terren; T4]** **[Kapitulli I Standardi III.5; Kapitulli I III.6]**
- 5.12 Universiteti përfshin përfaqësues të studentëve në organet e tij vendimmarrëse. Këshilli Studentor transmeton shqetësimet e studentëve tek Këshillat e Fakultetit. Këshillat e Fakultetit mbledhen një herë për semestër, gjë që i jep mundësi Universitetit të trajtojë çështjet e ngritura nga studentët. **[3.9; 3.1; T4; 4]** Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Studentor marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Administrimit. **[T7]** Sipas dispozitave të Statutit të ri, Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Studentor do të jenë anëtarë të Senatit Akademik, pasi zëri i studentëve më parë përfaqësohej nga Dekani / Zëvendës Dekani i studentëve. **[3.1; T3]** Studentët do të përfaqësohen në Këshillin e Etikës përmes Nënkryetarit të tyre. Gjithashtu përfaqësohen në Këshillin KVAZHC, si dhe janë përfshirë në mënyrë aktive në procesin e vetëvlerësimit. **[14.1; 6.4; T3]** Ndryshimet e parashikuara në Statutin e ri **pohojnë** përmirësimin e përfaqësimit të studentëve në komisionet vendimmarrëse. **[3.1; 6.29]** **[Kapitulli I Standardi III.7]**
- 5.13 Epoka ndjek një politikë mbështetëse në lidhje me aktivitetet jashtëshkollore të studentëve. Mbështeten veprimtaritë e 18 klubeve studentore që përfaqësojnë interesat e studentëve në fusha të ndryshme (ndërgjegjësim akademik, problemet sociale, sipërmarrja, art, kulturë, sport, TI, etj.). **[3.9; <http://clubs.epoka.edu.al/clubs-2>]** Studentët janë të përfshihen në turneun e ligës së futbollit të institucionit, si dhe aktivitete të tjera sportive. Sigurimi i hapësirës dhe mjediseve për aktivitete sportive dhe mbledhjet e klubeve studentore, dhe fakti që studentët ftohen të marrin pjesë në leksione të ftuarve dhe forume të hapura përfaqësojnë një **praktikë të mirë**. **[vizita në terren; 10.11; T4; T7]** Në kampus ofrohen shërbime të kujdesit shëndetësor për studentët dhe stafin përmes një mjeku me kohë të plotë, i cili ofron shërbim ambulator. **[vizita në terren]** **[Kapitulli I Standardi III.8]**
- 5.14 Universiteti ka sisteme efikase për nxitjen e punësimit të studentëve. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit regjistron vendet ku janë punësuar studentët. **[7.12; 6.5]** Të dhënat grumbullohen duke kontaktuar alumnit pas diplomimit, përfshirë postën elektronike dhe median sociale, dhe regjistrohen në bazën e të dhënave të alumnit. **[T6; 7.11]** Shkalla e punësimit të të diplomuarve është mbi mesataren kombëtare, me 75 për qind të të diplomuarve në vitin akademik 2015-2016 të punësuar në vitin e parë pas diplomimit. **[6.5 fq. 31; 51]** Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni organizon seminare dhe formim karriere për studentët në vitin e fundit, **[6.36]** para se të marrin pjesë në Panairin vjetor të Punës që organizohet në kampus. Panairi vjetor i Punës është zhvilluar për gjashtë vjet dhe tërheq një numër të madh punëdhënësish, gjë që iu jep mundësi studentëve të kenë qasje në vendet e lira të punës në tregun e punës. Organizimi i Panairit të Punës, i cili mbështetet në rrjetin e gjerë të kontakteve të Universitetit përbën një **praktikë të mirë** në mbështetjen e punësimit të studentëve. **[Kapitulli I Standardi III.9]**

- 5.15 Praktikant janë formalizuar si pjesë përbërëse e kurrikulës dhe kryerja e saj është e detyrueshme. Studentët duhet të kryejë praktikën gjatë pushimit veror dhe të ndjekin kurset e verës, sipas rastit. Praktikant dhe kurset verore janë pjesë e strategjisë së Universitetit për të përgatitur studentët për punësim, ku përfshihen edhe zhvillimi i aftësive "të buta". [T4; 9.4; 6.36] Bashkëpunimi me Qendrën e Simulimit në Tiranë ka bërë që të rritet ekspertiza e stafit dhe shërben për të zgjeruar njohuritë mbi tregun e punës dhe kërkesat për aftësi dhe kualifikim. [T2; T4; T7] Stafit akademik shqyrton rezultatet e arritura nga studentët gjatë praktikës, ku përfshihet edhe raporti i punëdhënësve, dhe i përdorin ato si informacion bazë për të krijuar profilet e arritjeve individuale. [T5; T6; 3: Kapitulli 2, Praktika gjatë studimeve universitare, 15] [*Kapitulli I Standardi II.9*]
- 5.16 Universiteti mbështet dhe udhëzon në mënyrë efikase trupën e tij studentore, së bashku me një varg aktivitete jashtëshkollore. Burimet, si një universitet kampus, përfshijnë një bibliotekë të pajisur mirë, mjedise për aktivitete sportive, të kohës së lirë dhe aktivitete të tjera. Sigurimi i hapësirës dhe mjediseve për aktivitete sportive, si dhe për mbledhjet e klubeve studentore çmohet një shembull i praktikës së mirë, siç u diskutua në pikën 5.13. Informacioni, këshillat dhe udhëzimet e dhëna nga Zyra e Karrierës dhe Dekani i Studentëve, Panairi vjetor i Punës dhe sistemi i bursave të Universitetit që tërheq studentë me arritje të larta, përfaqësojnë gjithashtu një praktikë të mirë dhe shërbejnë për të rritur punësueshmërinë e studentëve. Grupi i vlerësimit pohon ndryshimet në politikat dhe procedurat e pranimeve për të përmirësuar qasjen e studentëve me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar përfaqësimin e studentëve në Këshilla në bazë të Statutit të ri.

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- informacioni, këshillat dhe udhëzimet e dhëna nga Zyra e Karrierës dhe Dekani i Studentëve janë të qarta dhe në përgjigje të nevojave të studentëve (pika 5.8; *Kapitulli I Standardi III.1* dhe *Kapitulli I Standardi III.3*)
- sistemi i bursave që ofrohen për studentët me mesatare të lartë, veçanërisht për kandidatët që jetojnë në Bashkinë e Vorës (vendndodhja e Universitetit) (pika 5.10; *Kapitulli I Standardi III.4*).
- sigurimi i hapësirës dhe mjediseve për aktivitete sportive dhe mbledhjet e klubeve studentore, si dhe fakti që studentët ftohen të marrin pjesë në leksione të të ftuarve dhe forume të hapura (pika 5.13; *Kapitulli I Standardi III.8*)
- organizimi i Panairit të Punës, i cili mbështetet në rrjetin e gjerë të kontakteve të Universitetit (pika 5.14; *Kapitulli I Standardi III.9*).

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

### Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Universiteti ka përditësuar politikat dhe procedurat e tij të pranimit për të përfshirë pranimin e studentëve me aftësi të kufizuara (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.4**).
- përmirësimi i përfaqësimit të studentëve në komisionet vendimmarrëse (pika 5.12; **Kapitulli I Standardi III.7**).

## **Gjykimi**

**Standardet për studentët dhe mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.**

## Lista e dokumenteve

Numri rendor në AMS	Dokumentet
Aneks 1	1. Statistikat
Aneks 2	2. Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimet
Aneks 3	3. Kuadri Rregullator i Epokës 3.1. Organizimi dhe Menaxhimi 3.2 Diagram e organizimit 3.3. Lista e rregullave dhe rregulloreve 3.4 Përfaqësimi i studentëve 3.5. Çështjet e studentëve 3.6 Organizimi aktual i skemës së Universitetit Epoka 3.7 Skema e organizimit të Universitetit Epoka në vitin akademik 2017-2018 3.8 Kuadri i brendshëm ligjor i Universitetit Epoka 3.9 Numri i ndryshimeve të rregulloreve, udhëzimeve dhe akteve të tjera të brendshme të Universitetit Epoka
Aneks 4	4 Proceset e vendimmarrjes 4.1 Mbledhjet e organeve vendimmarrëse të Universitetit Epoka në vitin 2016 4.2 1 Organ vendimmarrës: Këshilli i Lartë i Universitetit Epoka në vitin 2016 4.3 Organ vendimmarrës: Senati i Universitetit Epoka në vitin 2016 4.4 Organ vendimmarrës: Këshilli i Administrimit i Universitetit Epoka për vitin 2016 4.5 Organ vendimmarrës: Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë (KVAZHC) për vitin 2016 4.6 Organ vendimmarrës: Këshilli i Profesorëve të Fakultetit Ekonomik dhe Shkencave Administrative, 2016 4.7 Organ vendimmarrës: Bordi i Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Administrative për vitin 2016 4.9 Organ vendimmarrës: Këshilli i Profesorëve i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë për vitin 2016 4.10 Organ vendimmarrës: Bordi Administrativ i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë për vitin 2016 4.11 Organi vendimmarrës: Bordi i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë për vitin 2016 4.12 Harta e procesit funksional 4.13 Diplomimi i Studentëve 4.14 Kuotat e pranimi 4.15 Blerja e librave 4.16 Hapja e programeve të reja studimore 4.17 Publikime 4.18 Ofrimi i bursave për kategori të caktuara 4.19 Provimi përfundimtar i përgjithshëm 4.20 Miratimi i Statutit të Universitetit Epoka
Aneks 5	5. Lista e veprimtarive kërkimore dhe konferencave 5.11. Veprimtari kërkimore të Epokës 5.2 Të dhëna të përgjithshme 5.3 Lista e botimeve 5.4 Konferencat 5.5 Projektet e kërkimit dhe zhvillimit 5.6 Aplikimi për projekte në programe ndërkombëtare

	5.7 Lista e Publikimeve 5.8 Lista e konferencave të mbështetura financiarisht nga Epoka
Aneks 6	6. Shembuj të dokumentacionit që ilustron procedurat dhe komisionet e Universitetit 6.1 Organizimi dhe menaxhimi 6.2 Raporti i auditit 2015 6.3 Agjenda e mbledhjeve të Senatit akademik 6.4 Agjenda e mbledhjeve të Këshillit KVAZHC 6.5 Raport vjetor 6.6 Bashkëpunimi dhe partneriteti 6.7 Arsytimi i projektit në lidhje me nevojat e Shqipërisë dhe rajonit 6.8 Marrëveshja e bashkëpunimit 6.9 PGM - Certifikata ISO 6.10 Vende të lira pune - Njoftim 6.11 Vendim për plotësimin e vendeve të lira të punës. 6.12 Burime 6.13 Përfshirja e fakultetit në zhvillimin e politikave kombëtare të kërkimit dhe arsimit të lartë. 6.14 Promovimi dhe dhënia e titujve akademikë 6.15 Aktivitete për integrimin e stafit 6.16 Burimet financiare 6.17 Nevojat e Departamentit 6.18 Sistemi i informacionit 6.19 Udhëzuesi për studentët TIK. 6.20 Diploma dhe Shtojca 6.21 Caktimi i kursit për FESHA dhe FAI 6.22 Miratimi i ndryshimeve të kurrikulës në BINF 6.23 Lista e notave të studentit 6.24 Vendimet e Senatit në lidhje me kriteret e regjistrimit 6.25 Kërkesat për njohje e gjuhës angleze 6.26 Programet e studimit dhe objektivat 6.27 Vlerësimi i mësimdhënies dhe kërkimit 6.28 Vlerësimi i mësimdhënies nga grup kolegësh 6.29 Vlerësimi i mësimdhënies nga studentë 6.30 Vlerësim akademik 6.31 Stafi akademik për vitin akademik 2017-2018 6.32 Aktivitetet e kërkimit dhe formimit 6.33 Aktivitetet e formimit 6.34 Çështjet e studentëve 6.35 Pranimi i studentëve 6.36 Programi i planifikimit të karrierës 6.37 Të dhënat e studentëve 6.38 Shërbimet e studentëve 6.39 Karta e studentit 6.40 Kurset përmirësuese 6.41 Procedurat e Zyrës 6.42 Procedurat e Zyrës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median 6.43 Procedurat e Zyrës së Pranimi 6.44 Udhëzuesi i stafit 6.45 Studim i kërkimit të tregut për hapjen e ditës së karrierës në interesin e publikut për drejtësi 6.46 Model syllabusi i kursit
Aneks 7	7 Planet Strategjike dhe Vlerësimi 7.1 Plani Strategjik i Epokës 2013-17.

	<p>7.2 Raporti i ndërmjetëm vlerësimi i planit strategjik të Universitetit Epoka 2013-2017</p> <p>7.3 Planet strategjike të departamenteve</p> <p>7.4 Planit strategjik i Departamentit Financë-Bankë 2017-2022</p> <p>7.5 Planit strategjik i Departamentit Administrim Biznesi 2017-2022</p> <p>7.6 Planit strategjik i Departamentit të Ekonomisë 2017-2022</p> <p>7.7 Planit strategjik i Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare 2017-22</p> <p>7.8 Planit strategjik i Departamentit të Arkitekturës 2017-2022</p> <p>7.9 Planit strategjik i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike 2017-2022</p> <p>7.10 Planit strategjik i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit 2017-2022</p> <p>7.11 Lista e strategjive dhe politikave të punësimit</p> <p>7.12 Lista e studimeve të tregut të punës dhe anketimeve</p>
Aneks 8	8 Kuadri ligjor kombëtar
Aneks 9	<p>9 Lista e Partnerëve</p> <p>9.1 Partnerët e arsimit të lartë</p> <p>9.2 Bashkëpunime sipas programit të vendit dhe bashkëpunimit</p> <p>9.3 Lista e partnerëve të biznesit dhe industrisë</p> <p>9.4 Lista e shoqërive ku kanë kryer praktika studentët</p> <p>9.5 Lista e partnerëve të biznesit</p> <p>9.6 Lista e partnerëve të institucioneve qeveritare</p> <p>9.7 Forumet e hapura në Universitetin Epoka</p> <p>9.8 Lista e ofruesve të shërbimeve në Universitetin Epoka</p>
Aneks 10	<p>10 Burimet</p> <p>10.1 Sistemi Ndërveprues i Epokës</p> <p>10.2 Shërbime të përgjithshme për studentët dhe fakultetin</p> <p>10.3 Burimet e studentëve</p> <p>10.4 Burimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies</p> <p>10.5 Çështjet e studentëve</p> <p>10.6 Menaxhimi i burimeve të fakultetit (financa, harduer, dokumente).</p> <p>10.7 Pajisjet dhe inventari</p> <p>10.8 Mjediset e mësimdhënies dhe laboratorët</p> <p>10.9 Mensa</p> <p>10.10 Biblioteka</p> <p>10.11 Ambientet e kohës së lirë</p> <p>10.12 Parkimi</p> <p>10.13 Vlerësimi mbi bazën e kriterëve ligjore</p> <p>10.14 Aspekte financiare: Procesi i buxhetimit në Universitetin Epoka</p> <p>10.15 Tabela 1: Mjediset e mësimdhënies dhe laboratorët</p> <p>10.16 Tabela 2: Klasat e përdorura gjatë vitit akademik 2016-2017</p> <p>10.17 Tabela 3: Auditorët e përdorur gjatë vitit akademik 2016-2017</p> <p>10.18 Tabela 4: Laboratorët e përdorur gjatë vitit akademik 2016-2017</p> <p>10.19 Tabela 5: Numri i mjediseve mësimore dhe kompjuterë</p> <p>10.20 Tabela 7: Kënaqja me shërbimin e mensës</p> <p>10.21 Tabela 8: Përdorimi i bibliotekës në vitin akademik 2015-16</p>
Aneks 11	11 Rezultatet e anketimit të stafit
Aneks 12	12 Rezultatet e anketimit të studentëve
Aneks 13	13 Raport vetëvlerësimi i Epokës
Nr. 2-3	<p>14 Kodi i Etikës</p> <p>14.1 Udhëzimet e kodit të etikës</p> <p>14.2 Vendimet e propozimeve për udhëtim dhe studime</p>
Nr. 14	15. Lista e praktikave të ofruara nga Universiteti në 2 vitet e fundit.
Nr. 15	16. Përshkrimi i punës për rolin e Dekanit të Studentëve.



Nr. 16-23	17. Informacion mbi rolin e Qendrës së Edukimit të Vazhdueshëm.
Nr. 4-13 Nr. 24-42	18. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të administrimit. 18.1- Mbledhje datë 31.05.2016; 18.2 - Mbledhje datë 17.01.2017; 18.3 - Mbledhje datë 28.03.2017. 18.4 - Vendimet e Këshillit të Administrimit
Nr. 43	19. proceset e marrjes së vendimeve, përfshirë raportimin vjetor të monitorimit dhe vlerësimit dhe: <i>Raportin Vjetor të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit si shembull.</i>
Nr. 44-51	20. Lista e anëtarëve të Këshillit të Profesorëve, duke përfshirë anëtarët e jashtëm, dhe një kopje e sferës së kompetencave së Këshillit. 20.1 - Anëtarët e Këshillit të Profesorëve; 20.2 - Procesverbalet e Këshillit të Profesorëve; 20.3 - Vendimet e Këshillit të Profesorëve; 20.4 - Shpërndarja e Vendimeve të Këshillit të Profesorëve.
Nr. 52-58 dhe Nr.125	21. Mbështetja financiare e ofruar nga Universiteti për pjesëmarrjen e stafit akademik në aktivitetet kërkimore ndërkombëtare.
Nr. 59-62	22. Shembull i fletëpalosjeve dhe broshurave mbi Universitetin dhe shpërndarja e tyre tek studentët e ardhshëm për programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Anglisht dhe Shqip
Nr. 63	23. Pajtueshmëria me kërkesat e akomodimit të certifikuara nga eksperti i jashtëm.
Nr. 64	24. Procedura e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.
Nr. 65	25. Dëshmia e "Lejes Higjienike", e cila mbulon aspektet e përbushjes së standardit për kontrollin e zhurmës, ngrohjes, alarmi i zjarrit, shuarja e zjarrit etj. (Shqip)
Nr. 66	26. Informacion mbi programet profesionale të TI-së të ofruara në laboratorët kompjuterikë dhe një koment i shkurtër mbi mënyrën si ato kontribuojnë në rezultatet e përvetësimit të programit.
Nr. 67-68	27. Procedurat për hartimin dhe miratimin e buxhetit për vitin 2017, përfshirë miratimin nga Bordi. Sqarim mbi mënyrën e zbatimit të buxhetit dhe kush është përgjegjës për monitorimin e shpenzimeve dhe vlerën e parasë. 27.1 - Procesi i buxhetimit në Universitetin Epoka është paraqitur tashmë si shtojcë në Aneksin 10: Kapitulli 3 i Raportit të Vetëvlerësimit. 27.2 - Nevojat e Departamentit për 2017-2018 janë paraqitur si shtojcë në Aneksin 6: Kapitulli 2.2.1 i Raportit të Vetëvlerësimit.
Nr. 69	28. Qasja e stafit dhe studentëve në sistemet e informacionit të TI-së në kurse dhe informacionin e kurseve. Lista e programeve që mund të kenë qasje
Nr. 70	29. Rregullore e programeve të studimeve Bachelor, Master dhe Doktoraturë (brenda një fushe të lëndës ose Fakultetit, duke përfshirë kërkesat për ecurinë nga një cikël tek tjetri dhe lidhjet mes kurrikulave.
Nr. 71	30. Kërkesat e kualifikimit për stafin që jep mësim në programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, duke përfshirë stafin me kohë të pjesshme për këto programe, të dhëna si shembuj në pyetjen 16.
Nr. 72	31. Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit të përbashkët me Universitetin e Mainzit.
Nr. 73-76	32. Lista e ngarkesës vjetore të punës, duke përfshirë orët e mësimit për stafin akademik me kohë të plotë.
Nr. 77-79	33. Përshkrimet e punës dhe informacion në lidhje me ngarkesën e punës për këshilltarët personal të studentëve.

Nr. 80-84	34. Shqyrtimi nga kolegët i provimeve të përgjithshme përfundimtare.
Nr. 85	35. Përshtypjet e studentëve, përfshirë mendimet për informacionin para fillimit të kursit.
Nr. 86-90	36. Programi i hyrjes
Nr. 91	37. Kopje e Udhëzuesit të Studentëve 37.1 - Udhëzuesi i Studentëve është i cituar gjithashtu në Raportin e Vetëvlerësimit: referencë Nr. 326. Shiko për shembull Udhëzuesin e Studentëve 2016-2017. <a href="http://epoka.edu.al/mat/Student_Guide_2016-2017.pdf">http://epoka.edu.al/mat/Student_Guide_2016-2017.pdf</a>
Nr. 92-100	38. Rishikim i programit / raporte vjetore të monitorimit dhe rishikimit, nga një për secilin, program të ciklit të parë dhe të dytë. (Shqip me rezultate të shkurtra në anglisht) 38.1 - Raportet e Vlerësimit të Brendshëm dhe Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për programet e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Bachelor në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike, Master shkencor në Ekonomi dhe Master shkencor në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike.
Nr. 101-102	39 Vlerësimi i stafit mësimdhënës
Nr. 103	40. Përdorimi i anketimit të kënaqjes së studentëve me mësimdhënien për të rritur më tej cilësinë e të nxënit dhe mësimdhënies.
Nr. 104-107	41. Dokumenti i Strategjisë së Universitetit 41.1 Strategjia e kërkimit universitar 41.2 Plani strategjik i Epokës 41.3 Vlerësimi i ndërmjetëm i planit strategjik të Epokës 41.4 Rregullore e kërkimit shkencor
Nr. 108-111	42. Shembull i një procedure të nisur nga Bordi i KVAZHC, e cila ka sjellë përmirësimin e programeve të studimit dhe cilësinë e mësimdhënies. 42.1 Vendimet 42.2 Agjenda e formimit të mësuesve 42.3 Raport i formimit të mësuesve
Nr. 112	43. Shembull i një regjistri kursi.
Nr. 113-118	44 Procedura për vlerësimin dhe shpërblimin monetar të stafit akademik në lidhje me arritjet e kërkimit
Nr. 119	45. Të dhëna statistikore për mobilitetin e stafit të kërkimit për vitin 2016.
Nr. 120-121	46. Mbikëqyrja nga Bordi i Fakultetit i një teme diplomimi të ciklit të dytë.
Nr. 122	47. Kopje e politikës së bursave 2017-18 për romët dhe egjiptianët e Ballkanit dhe çdo kuotë e programeve. 47.1 - Një kopje e vendimit për ofrimin e bursave për romët dhe egjiptianët e Ballkanit është paraqitur tashmë si shtojcë e Aneksit 4: Kapitulli 2.1.6 i Raportit të Vetëvlerësimit.
Nr. 123	48. Numri aktual i bursave të dhëna për dy vitet e fundit për secilën prej kategorive të veçanta dhe përfshin studentët me rezultate të shkëlqyera në shkollën e mesme.
Nr. 124	49. Raporti vlerësimi i bibliotekës dhe burimeve.
Nr. 126-130	50. Shembull i një programi të Ditës së Orientimit 50.1 - Lidhjet; 50.2 - Fotot; 50.3 - Listat e pjesëmarrjes; 50.4 - Prezantim në PowerPoint.
Nr 131	51. Të dhëna për statistikat kombëtare të punësimit dhe si renditen të diplomuarit e Universitetit
Nr	52 Fletë provimi të vlerësuara

	53 Shembuj të ankesave të vlerësimit të notave
	54 Dosje të kursit
	55 Projektformular i vlerësimit
	56 Fleta e të dhënave të përditësuara të buxhetit për të përfshirë parashikimet e vitit 2016

<b>Nr.</b>	<b>Mbledhje</b>
T1	Mbledhje me ndërmjetësin dhe ekipin e vetëvlerësimit
T2	Mbledhje me Rektorin
T3.	Mbledhje me stafin e lartë
T4	Mbledhje me studentët
T5	Mbledhje me stafin mësimdhënës
T6	Mbledhje me punëdhënës dhe alumni
T7	Mbledhje me personelin mbështetës